Banka e Shqipërisë

RAPORTI TREMUJOR I POLITIKËS MONETARE

RAPORTI I REFEROHET DEKLARATËS SË POLITIKËS MONETARE TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2014, MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 2, DATË 28.01.2015

Janar 2015

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë,
sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; Faks: + 355 4 2419409/10/11
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Tirazhi: 310 kopje
Shtypur në shtypshkronjën Albdesign

P Ë R M B A J T J A

OBJEKTIVI 7

1. DEKLARATË E KËSHILLIT MBIKËQYRËS 8

2. STABILITETI I ÇMIMEVE DHE OBJEKTIVI I BANKËS SË SHQIPËRISË 12

2.1 Objektivi i inflacionit dhe politika monetare 12
2.2 Ecuria e inflacionit sipas kategorive 13

3. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE 16

3.1 Ambienti i jashtëm i ekonomisë 17
3.2 Prodhimi i brendshëm bruto dhe ecuria e kërkesës agregate 21
3.3 Gjendja ciklike e ekonomisë, pagat, kostot e punës dhe prirjet e inflacionit 36
3.4 Çmimet e huaja dhe inflacioni i importuar 39

4. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE 42

4.1 Zhvillimet në tregjet financiare 42
4.2 Ecuria e kreditimit 48
4.3 Ecuria e treguesve monetarë 52

H A P Ë S I R A I N F O R M U E S E

Hapësirë informuese 1.	*Ecuria e çmimeve në tregun e banesave*	*25*
Hapësirë informuese 2.	*Zhvillimet në Bilancin e Pagesave në tremujorin e tretë 2014*	*35*
Hapësirë informuese 3.	*Përmbledhje e rezultateve nga Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues*	*46*
Hapësirë informative 4.	*Rezultatet e Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues në vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore (EQJL), gjashtëmujori i dytë 2014*	*51*

P Ë R M B A J T J A E T A B E L A V E

2. Stabiliteti i çmimeve dhe objektivi i Bankës së Shqipërisë

Tabelë 1.	*Kontributi i kategorive kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindje)*	*14*

3. Zhvillimet makroekonomike

Tabelë 2.	*Disa prej treguesve kryesorë makroekonomikë*	*17*
Tabelë 3	*Tregues ekonomikë për vendet e rajonit*	*19*
Tabelë 4.	*Tregues të bilancit të pagesave*	*36*

P Ë R M B A J T J A E G R A F I K Ë V E

2. Stabiliteti i çmimeve dhe objektivi i Bankës së Shqipërisë 12
Grafik 1. Inflacioni vjetor (në përqindje) 12
Grafik 2. Norma bazë e interesit dhe inflacioni bazë vjetor 13
Grafik 3. Inflacioni vjetor i kategorisë ushqime (në përqindje) 14
Grafik 4. Inflacioni vjetor sipas kategorive të mallrave dhe të shërbimeve (në përqindje) 15

3. Zhvillimet makroekonomike
Grafik 5. Ndryshimi vjetor i çmimeve bazë (në përqindje) 19
Grafik 6. Normat bazë të interesit të disa bankave qendrore 20
Grafik 7. Ecuria e disa treguesve financiarë në tregjet ndërkombëtare 20
Grafik 8. PBB-ja dhe dinamika vjetore e komponentëve të kërkesës agregate 22
Grafik 9. Kontributet e sektorëve të ekonomisë në ecurinë e vlerës së shtuar dhe treguesit e besimit 23
Grafik 10. Kontributet e degëve në ecurinë e vlerës së shtuar në industri dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në këtë sektor 24
Grafik 11. Ecuria e vlerës së shtuar dhe norma e shfytëzimit të kapaciteteve në ndërtim 25
Grafik 12. Indeksi i Çmimit të Banesave dhe raporti i tij ndaj Indeksit të Qirasë së Banesave 25
Grafik 13. Ecuria e vlerës së shtuar në sektorin e bujqësisë, gjuetisë dhe pyjeve, si dhe kontributi i saj në ekonomi 26
Grafik 14. Kontributet e degëve në ecurinë e vlerës së shtuar në shërbime dhe 26
normat e shfrytëzimit të kapaciteteve në këtë sektor 26
Grafik 15. Tregues të tërthortë të konsumit privat dhe burimeve të financimit të tij 28
Grafik 16. Tregues të tërthortë të investimeve private 29
Grafik 17. Orientimi i politikës fiskale, i përafruar nga ndryshimi i deficitit primar 29
Grafik 18. Ndryshimi vjetor i totalit të shpenzimeve 3-mujore, sipas kontributeve të zërave kryesorë (majtas), dhe ndryshimet vjetore (për flukset 3-mujore) të zërave kryesorë të shpenzimeve (djathtas) 30
Grafik 19. Ndryshimi vjetor i të ardhurave 3-mujore, sipas kontributeve të zërave kryesorë (majtas), dhe ndryshimet vjetore (për flukset 3-mujore) të zërave kryesorë të të ardhurave (djathtas) 32
Grafik 20. Deficiti buxhetor kumulativ në përqindje të PBB-së (majtas) dhe instrumentet e financimit të tij sipas tremujorëve, në mld lekë (djathtas) 32
Grafik 21. Kontributi i eksporteve neto në kërkesën agregate (në pikë përqindje) 33
Grafik 22. Orientimi i importeve dhe eksporteve sipas kategorive (vlera në milionë lek) 34
Grafik 23. Hendeku i prodhimit dhe kontributi i inflacionit bazë (majtas); norma e papunësisë (djathas) 37*
Grafik 24. Treguesit e pagave në sektorët e ekonomisë dhe tregues të produktivitetit 38
Grafik 25. Prirjet afatgjata të inflacionit (majtas) dhe prirjet afatshkurtra (djathtas) 39
Grafik 26. TPHI-ja dhe kontributet e përbërësve të saj (majtas) dhe kontributi i inflacionit të importuar dhe të brendshëm në atë total vjetor (djathtas) 40
Grafik 27. Pritjet e inflacionit nga agjentë të ndryshëm dhe treguesi i masës së ankorimit 41

4. Zhvillimet monetare dhe tregjet financiare 42
Grafik 28. Operacionet e tregut të hapur të BSH-së (majtas) dhe ecuria e normave të interesit në tregun ndërbankar (djathtas) 43
43
Grafik 29. Ecuria e yield-eve në tregun primar 43
Grafik 30. Normat e interesit të kredisë së re në lekë 44
Grafik 31. Normat e interesit të kredisë së re në euro dhe ato për depozita 45
Grafik 32. Standardet e kredisë për bizneset dhe per individët (balanca neto) 46

Grafik 33. Kërkesa për kredi për bizneset dhe individët (balanca neto) 47
Grafik 34. Ndryshimet vjetore të indeksit NEER, indeksi i presioneve në tregun valutor dhe kursi bilateral i këmbimit 47
Grafik 35. Kredia për ekonominë kundrejt vlerës së shtuar dhe PBB-së nominale 49
Grafik 36. Kredia për biznese sipas monedhës (majtas) dhe qëllimit të përdorimit (djathtas) 49
Grafik 37. Kredia për individë sipas monedhës (majtas) dhe qëllimit të përdorimit (djathtas) 50
Grafik 38. Tregues të ndryshëm mbi ekspozimet e grupeve bankare në rajon 52
Grafik 39. Zhvillimet në agregatët monetarë 53
Grafik 40. Zhvillimet në depozitat e përfshira në M3 (majtas) dhe në depozitat totale (djathtas) 54

OBJEKTIVI

Objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Nxitja e investimeve afatgjata, ruajtja e fuqisë blerëse të parasë, rritja e eficiencës së shpërndarjes së fondeve në ekonomi dhe mbështetja e stabilitetit financiar, janë disa nga përfitimet e një mjedisi ekonomik të karakterizuar nga stabiliteti i çmimeve. Ky stabilitet është kontributi më i madh që banka qendrore mund të japë në mbështetje të një rritjeje ekonomike të qëndrueshme dhe afatgjatë.

Në përputhje me strategjinë e miratuar në Dokumentin e Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë angazhohet në arritjen dhe ruajtjen e inflacionit vjetor në nivelin 3.0 për qind në një periudhë afatmesme. Shpallja e objektivit sasior për inflacionin synon ankorimin e pritjeve të agjentëve ekonomikë dhe uljen e primeve të rrezikut.

Në përmbushje të këtij qëllimi dhe për të forcuar transparencën e saj, Banka e Shqipërisë përgatit dhe publikon çdo tre muaj Raportin e Politikës Monetare. Ky Raport është instrumenti kryesor i komunikimit të politikës monetare me publikun. Ai paraqet një tablo gjithëpërfshirëse të zhvillimeve më të fundit makroekonomike dhe të faktorëve që priten të ndikojnë në ecurinë e çmimeve të konsumit në vend.

Raporti i Politikës Monetare për tremujorin e katërt të vitit 2014 i referohet Deklaratës së Politikës Monetare të Bankës së Shqipërisë për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2014, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 2, datë 28.01.2015. Analiza ekonomike dhe monetare në këtë raport mbështetet mbi të dhënat më të fundit në dispozicion, deri më 15 janar 2015.

1. DEKLARATË E KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Ekonomia shqiptare shënoi përmirësim në gjysmën e dytë të vitit 2014, por presionet e përgjithshme inflacioniste mbetën të dobëta dhe inflacioni vazhdoi të qëndrojë poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë. Ndonëse në rritje, kërkesa agregate është ende e pamjaftueshme për të siguruar shfrytëzim të plotë të kapaciteteve prodhuese të ekonomisë dhe për të gjeneruar rritje të qëndrueshme të punësimit, të pagave, të marzheve të fitimit dhe të çmimeve finale në ekonomi. Edhe faktorët e ofertës - si çmimet e lëndëve të para e të mallrave të importit dhe ecuria e pritjeve inflacioniste - vazhdojnë të prodhojnë presione të ulëta për rritjen e çmimeve të konsumit. Në veçanti, rënia e inflacionit të importuar në tremujorin e katërt ka sjellë një ecuri të kundërt të trajektoreve të rritjes ekonomike dhe të inflacionit në këtë periudhë.

Ambienti i përgjithshëm ekonomik, i karakterizuar nga presione të dobëta inflacioniste, nga rritje ekonomike nën potencial dhe nga prime të larta rreziku në tregjet financiare, ka diktuar ndjekjen e një politike monetare lehtësuese gjatë tremujorëve të fundit. Natyra lehtësuese e politikës monetare u forcua më tej gjatë kësaj periudhe, nëpërmjet reduktimit të normës bazë të interesit, sinjalizimit të ruajtjes së natyrës stimuluese të politikës monetare edhe në të ardhmen, si dhe vazhdimit të injektimit të likuiditetit në sistemin bankar. Në përgjigje të kësaj politike stimuluese, tregjet financiare janë karakterizuar nga tendenca rënëse të normave të interesit. Kostot e financimit të sistemit bankar dhe normat e interesit të kredisë në lekë kanë zbritur në minimumet e tyre historike gjatë këtij tremujori. Duke reflektuar transmetimin e politikës monetare, kredia në lekë ka shënuar përmirësim gjatë dy tremujorëve të fundit. Megjithatë, transmetimi i plotë i politikës monetare në ekonomi vazhdon të vuajë nga hezitimi i bizneseve për t'u angazhuar në investime afatgjata dhe nga oreksi i ulët i sistemit bankar për të marrë përsipër rrezik.

Rritja ekonomike e tremujorit të tretë dhe vlerësimet e saj për tremujorin e katërt, kanë qenë në kahun e sipërm të pritjeve tona. Në të kundërt, ecuria e inflacionit në tremujorin e katërt ka qenë në kahun e poshtëm të parashikimeve tona. Ndonëse parashikimet tona afatmesme nuk kanë pësuar ndryshime të ndjeshme, në afat të shkurtër, ecuria e pritur e rritjes ekonomike është zhvendosur për lart, ndërsa ajo e inflacionit është zhvendosur për poshtë. Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se zhvillimet aktuale e të pritura të ekonomisë, ritheksojnë nevojën për ndjekjen e një politike monetare stimuluese. Parashikimet afatmesme dhe kthimi i inflacionit në objektiv mbeten të kushtëzuar nga rekuperimi i konsumit dhe investimeve private. Në këto rrethana, me miratimin e kësaj deklarate, Këshilli Mbikëqyrës e gjykoi të nevojshme reduktimin e mëtejshëm të normës bazë të interesit, duke e zbritur atë në nivelin 2.0%. Kjo lëvizje krijon kushte monetare të përshtatshme për kthimin e inflacionit në objektiv dhe të ekonomisë në ekuilibër në një horizont afatmesëm.

Në vazhdim do të paraqesim një tablo më analitike të zhvillimeve aktuale e të pritura ekonomike, si dhe një diskutim më të plotë të politikës monetare.

Inflacioni në muajin dhjetor shënoi vlerën 0.7%. Rënia e theksuar e inflacionit gjatë këtij muaji u diktua nga rritja e ulët e çmimeve të prodhimeve ushqimore dhe nga rënia e vazhduar e çmimit të naftës, e cila ka ulur më tej kostot e prodhimit e të transportit të mallrave dhe të shërbimeve. Në aspektin makroekonomik, nivelet e ulëta të inflacionit vazhdojnë të përcaktohen nga ecuria e dobët e kërkesës agregate, por ngadalësimi i fortë i inflacionit gjatë tremujorit të fundit duket se i detyrohet më së shumti rënies së inflacionit të importuar. Ambienti i jashtëm ekonomik ka ushtruar presione dizinflacioniste mbi ekonominë shqiptare dhe kjo tendencë pritet të jetë e pranishme edhe gjatë vitit 2015.

Parashikimet tona sugjerojnë se inflacioni do të vijë në rritje graduale, duke konverguar në objektivin tonë prej 3% në periudhën afatmesme. Ky parashikim faktorizon dhe mbetet i kushtëzuar nga parashikimet tona për një kthim të shpejtë të ekonomisë në ekuilibër. Rritja ekonomike parashikohet të forcohet dhe të shoqërohet me përmirësime në tregun e punës dhe të pagave. Nga ana tjetër, inflacioni i importuar parashikohet të mbetet i zbehtë përgjatë horizontit afatmesëm, ndërsa pritjet inflacioniste pritet të lëvizin gradualisht drejt objektivit të Bankës së Shqipërisë.

Ecuria e ekonomisë në gjashtëmujorin e dytë të vitit është në linjë me skenarin e mësipërm. Vlera reale e shtuar nga sektorët e ekonomisë shënoi një rritje vjetore me 3.3% gjatë tremujorit të tretë të vitit 2014, duke regjistruar përmirësim në krahasim me rritjen e regjistruar në tremujorin e parë dhe të dytë. Struktura sektoriale e rritjes së prodhimit ishte e balancuar, sikurse tregohet nga kontributi pozitiv në rritje, si i sektorit të shërbimeve ashtu edhe i sektorit të prodhimit. Të dhënat e tërthorta të disponuara sugjerojnë se rritja ekonomike ka vazhduar edhe gjatë tremujorit të katërt. Bazuar në këto vlerësime, Banka e Shqipërisë pret një rritje ekonomike në përmirësim progresiv gjatë viteve 2014 – 2016.

Nga ana e shpenzimeve, rritja ekonomike është mbështetur kryesisht nga kërkesa konsumatore dhe më pak nga aktiviteti investues i sektorit privat dhe atij publik. Përmirësimi i besimit në ekonomi, normat e ulëta të interesit dhe zgjerimi i kredisë, rritja e punësimit, si dhe shlyerja e detyrimeve të prapambetura nga sektori publik, vlerësohen të kenë mbështetur shpenzimet e sektorit privat gjatë tremujorëve të fundit. Parashikimet tona sugjerojnë se kjo ecuri do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Kërkesa e huaj ka rezultuar e dobët dhe shkëmbimet e mallrave e shërbimeve me partnerët tanë tregtarë kanë dhënë një kontribut neto negativ prej 3.8 pikësh përqindjeje në rritjen ekonomike të tremujorit të tretë. Deficiti i eksporteve reale neto u zgjerua me 18% në tremujorin e tretë të vitit. Kjo ecuri reflekton rritjen e ngadaltë të eksporteve shqiptare, përballë një ritmi më të shpejtë të rritjes së importeve. Në aspektin makroekonomik, rritja e ngadaltë e eksporteve pasqyron kërkesën e dobët të partnerëve tanë tregtarë, por edhe

goditje të ofertës në disa sektorë të caktuar të prodhimit. Nga ana tjetër, rritja e importeve reflekton më së shumti tendencat e përmirësimit të konsumit e të investimeve në vend. Për tremujorin e fundit të vitit, parashikimet tona janë për një kontribut minimal negativ të eksporteve reale neto në ecurinë e kërkesës agregate.

Politika fiskale ka patur një natyrë konsoliduese gjatë vitit 2014. Kjo politikë është shprehur në tkurrjen e deficitit buxhetor, e cila ka reflektuar kryesisht rritjen e shpejtë të të ardhurave. Deficiti buxhetor për 11 muajt e parë të vitit 2014 rezultoi 41.3 miliardë lekë, ose 35.1% më i ulët se niveli i programuar për këtë periudhë dhe 31.9% më i ulët se një vit më parë. Deri në muajin nëntor, të ardhurat publike u rritën me 12.6% në terma vjetorë, ndërsa shpenzimet totale u rritën me rreth 5% në terma vjetorë. Megjithë natyrën konsoliduese, korrektimi fiskal nuk ka qenë i njëtrajtshëm gjatë vitit. Ky korrektim ka qenë i përqendruar në gjysmën e parë të vitit - ai ka qenë mjaft i ulët në tremujorin e tretë ndërsa tremujori i katërt vlerësohet të ketë prodhuar një stimul fiskal pozitiv. Si dhe më parë, Banka e Shqipërisë vazhdon të mbështesë politikën fiskale konsoliduese. Rritja e qëndrueshmërisë së financave publike ul primet e rrezikut në ekonomi. Ajo krijon premisa për ndjekjen e një politike monetare më stimuluese dhe rrit efektivitetin e transmetimit të saj në ekonomi.

Duke reflektuar mbi projeksionet për presione të ulëta inflacioniste dhe mbi praninë e kapaciteteve të pashfrytëzuara në ekonomi, Banka e Shqipërisë uli me 0.25 pikë përqindje normën bazë të interesit në muajin nëntor. Kjo ishte lëvizja e tretë në drejtim të lehtësimit të kushteve monetare gjatë vitit 2014. Stimuli monetar ka mundësuar reduktimin normave të interesit dhe përmirësimin e kushteve të financimit në ekonomi. Ndërkohë, kostoja e huamarrjes së qeverisë ka pësuar një rritje të lehtë, si pasojë e zhbalancimit të kërkesës dhe të ofertës në këtë treg. Normat e interesit për kredinë për sektorin privat kanë patur prirje rënëse gjatë gjithë vitit, çka është reflektuar edhe në përmirësimin e ritmeve të rritjes së kredisë gjatë gjysmës së dytë të vitit. Rritja vjetore e saj rezultoi 3.8% në fund të muajit nëntor, nga 1.6% që shënonte në fund të tremujorit të tretë të vitit. Në reflektim të politikës monetare stimuluese të Bankës së Shqipërisë, kredia në lekë e sistemit shënoi një rritje vjetore prej 9.3% në muajin nëntor, duke treguar një ecuri mjaft më të mirë se kreditimi në valutë. Megjithë tendencat përmirësuese, ecuria e kredisë vazhdon të mbetet e zbehtë, si pasojë e problemeve të kërkesës e të ofertës. Nga ana e kërkesës, rritja ekonomike nën potencial dhe pasiguria e sektorit real i detyron bizneset të shtyjnë në kohë planet e tyre të investimit dhe të kërkesave për financim. Nga ana e ofertës, ecuria e kredisë vazhdon të ndikohet negativisht nga niveli i lartë i kredive me probleme, të cilat rëndojnë bilancet e sistemit bankar; nga primet e larta të rrezikut në sektorë specifikë të ekonomisë, të cilat i bëjnë këto sektorë pak atraktivë për kreditim; dhe nga politikat konservatore të bankave mëma, të cilat imponojnë politika shtrënguese kreditimi në Shqipëri. Analizat dhe parashikimet e Bankës së Shqipërisë sugjerojnë se aktiviteti kreditues do të shënojë një përmirësim të ngadaltë gjatë vitit 2015.

Projeksionet tona makroekonomike flasin për mbyllje të hendekut negativ të prodhimit dhe për një kthim gradual të inflacionit në objektiv, në një periudhë

afatmesme. Në skenarin bazë, norma vjetore e inflacionit pritet të luhatet në intervalin 1.2%-3.8% pas katër tremujorëve, me një probabilitet ndodhjeje prej 90%, dhe të kthehet në objektivin tonë prej 3% në afat të mesëm. Kthimi gradual i inflacionit në objektiv do të udhëhiqet nga rritja ekonomike dhe kthimi i ekonomisë në ekuilibër.

Skenari i mësipërm rrethohet nga rreziqe prej të cilave dëshirojmë të evidentojmë dy. Së pari, ambienti i jashtëm ekonomik e financiar në rang evropian mbetet sfidues. E lidhur me të, gatishmëria e bankave për të marrë përsipër rrezik dhe për të kredituar sektorin publik e privat në vendet e Evropës Lindore, përfshi dhe Shqipërinë, shfaqet ende e ulët. Përkeqësimi i mëtejshëm i kësaj tabloje do të kërkonte marrjen e masave korrektuese dhe gjetjen e burimeve të reja të financimit. Së dyti, parashikimet tona janë të kushtëzuara në një masë të madhe nga përmirësimi i pritur i konsumit dhe i investimeve private. Nëpërmjet lehtësimit të kushteve të financimit në ekonomi, politika monetare krijon kushtet e duhura për nxitjen e tyre. Megjithatë, rritja e qëndrueshme e konsumit dhe investimeve do të varen nga përmirësimi i mëtejshëm i klimës së biznesit dhe nga thellimi i reformave strukturore, të cilat rritin produktivitetin e ekonomisë dhe forcojnë efektivitetin e politikës monetare.

Duke gjykuar mbi informacionin e disponuar, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të ulë me 0.25 pikë përqindje normën bazë të interesit, duke e sjellë atë në nivelin 2.00%. Transmetimi i këtij vendimi në tregjet financiare do të krijojë kushtet e duhura monetare për mbështetjen e rritjes ekonomike dhe për kthimin e inflacionit në objektiv. Gjithashtu, duke u nisur nga parashikimet e skenarit bazë, Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se arritja e objektivit të inflacionit në periudhën afatmesme do të kërkojë ruajtjen e kushteve të lehtësuara monetare edhe për disa tremujorë në vazhdim.

2. STABILITETI I ÇMIMEVE DHE OBJEKTIVI I BANKËS SË SHQIPËRISË

Presionet inflacioniste vazhduan të mbeten të ulëta në ekonomi, edhe gjatë tremujorit të katërt. Inflacioni mesatar i kësaj periudhe rezultoi në vlerën 1.3%, duke shënuar rënie krahasuar me tremujorin paraardhës dhe duke mbetur kështu, poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë. Në masën më të madhe, kjo tendencë u diktua nga rënia e theksuar e inflacionit në muajin dhjetor, si pasojë e rritjes së ngadaltë të çmimeve të ushqimeve dhe e reduktimit të çmimeve të naftës.

Projeksionet për nivele të ulëta dhe nën objektiv të inflacionit kanë kërkuar forcimin e kahut stimulues të politikës monetare. Banka e Shqipërisë uli në 2.25% normën bazë të interesit në muajin nëntor dhe vazhdoi të furnizojë tregun bankar me të gjithë likuiditetin e kërkuar. Kahu rezultant i politikave makroekonomike mbetet stimulues. Megjithatë, kërkesa private nuk ka shfaqur ende ritme të qëndrueshme rritjeje, si pasojë e hezitimit të familjeve dhe të biznesit në ndërmarrjen e konsumit dhe të investimeve, por edhe në reflektim të ofertës së shtrënguar të financimit nga sistemi bankar. Për të ardhmen, Banka e Shqipërisë vlerëson se ruajtja e kushteve lehtësuese monetare do të ndihmojë rritjen ekonomike, si dhe do të mundësojnë kthimin e inflacionit në objektiv në një periudhë afatmesme.

2.1 OBJEKTIVI I INFLACIONIT DHE POLITIKA MONETARE

Grafik 1. Inflacioni vjetor (në përqindje)



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Norma mesatare e inflacionit zbriti në 1.3% në tremujorin e fundit, pas vlerës 1.7% të shënuar në tremujorin paraardhës. Ecuria në rënie e inflacionit u diktua nga vlera e ulët e regjistruar në muajin dhjetor.[1] Rënia e theksuar e inflacionit në këtë muaj reflektoi rritjen e ulët të çmimeve të prodhimeve ushqimore dhe rënien e vazhduar të çmimit të naftës.

Nivelet e ulëta të inflacionit gjatë tremujorëve të fundit vazhdojnë të përcaktohen nga faktorët e kërkesës. Ecuria e dobët e kërkesës agregate nuk arrin të verë në shfrytëzim të plotë kapacitetet prodhuese të ekonomisë dhe krijon presione të dobëta për rritjen e pagave, të kostove të prodhimit dhe të marzheve të fitimit. Nga ana tjetër, rënia e inflacionit në tremujorin e fundit, dhe sidomos ajo shënuar në muajin dhjetor, i detyrohet dobësimit

[1] *Inflacioni vjetor i muajit dhjetor 2014 rezultoi 0.7%*

progresiv të faktorëve të ofertës, dhe veçanërisht rënies së inflacionit të importuar.

Nisur nga projeksionet për presione të ulëta inflacioniste dhe konsideratat për brishtësinë e kërkesës së brendshme në periudhën afatmesme, Banka e Shqipërisë uli me 0.25 pikë përqindje normën bazë të interesit në fund të muajit nëntor, duke e zbritur atë në nivelin minimal prej 2.25%. Kjo ishte lëvizja e tretë në drejtim të lehtësimit të kushteve monetare gjatë vitit 2014. Gjithashtu, komunikimi i ndjekjes së një politike monetare stimuluese edhe në periudhën e ardhshme, ka ndihmuar në rritjen e parashikueshmërisë dhe të sigurisë në tregjet financiare, si dhe në ankorimin e pritjeve për inflacionin dhe në uljen e normave reale afatgjata të interesit.

Lehtësimi i politikës monetare ka kompensuar politikën fiskale konsoliduese të ndjekur gjatë vitit, duke ruajtur një kah stimulues të politikave makroekonomike. Kjo politikë ka mundësuar reduktimin e normave të interesit dhe përmirësimin e kushteve të financimit në ekonomi. Normat e interesit të kredisë në lekë kanë patur prirje rënëse gjatë vitit, çka është reflektuar edhe në një rritje më të shpejtë të kësaj kredie gjatë gjysmës së dytë të vitit. Ecuria më e mirë e kredisë ka mbështetur përmirësimin e konsumit dhe të investimeve private gjatë kësaj periudhe.

Pritjet për presione të ulëta inflacioniste kërkojnë ndjekjen e një politike monetare stimuluese edhe gjatë vitit në vazhdim. Kushtet e lehtësuara monetare do të ndihmojnë rritjen e kërkesës së brendshme dhe kthimin e ekonomisë në ekuilibër, duke krijuar kushtet për kthimin e inflacionit në objektiv brenda një periudhe afatmesme.

Grafik 2. Norma bazë e interesit dhe inflacioni bazë vjetor



Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.2 ECURIA E INFLACIONIT SIPAS KATEGORIVE

Rënia e inflacionit gjatë tremujorit të katërt u shkaktua thuajse tërësisht nga ecuria e çmimeve të ushqimeve dhe të naftës. Inflacioni i kategorisë "Ushqime të papërpunuara" u reduktua ndjeshëm gjatë kësaj periudhe, duke rezultuar në një kontribut prej 0.7 pikësh përqindje më të ulët te norma e inflacionit.[2] Pjesa më e madhe e rënies së kontributit të kësaj kategorie është rezultat i inflacionit të ulët të shënuar prej saj në muajin dhjetor. Gjatë këtij muaji u verifikua një rritje mujore me 3.4% e ushqimeve të papërpunuara, ose 3 pikë përqindje më e ulët se mesatarja e këtij treguesi gjatë pesë viteve të fundit. Në veçanti, kontributi në rënie i kësaj kategorie u ndikua nga rënia me 0.7 pikë përqindje e kontributit të nëngrupit "Perime" gjatë muajit dhjetor, duke patur një kontribut dhe inflacion në vlera negative.

[2] *Kontributi i kategorisë "Ushqime të papërpunuara" ra nga 1.5 p.p. në 0.8 p.p..*

Grafik 3. Inflacioni vjetor i kategorisë ushqime (në përqindje)



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë

Kontributi i kategorisë "*Ushqime të përpunuara*" shënoi rritje krahasuar me një tremujor më parë. Norma vjetore e inflacionit u rikthye në shifra pozitive (megjithëse shumë e ulët, 0.5%). Më konkretisht, lëvizja në çmimet e këtyre mallrave ishte rezultat i rritjes së çmimit të duhanit. Kjo kategori ndikoi me 0.2 pikë përqindje mbi inflacionin total. Pavarësisht rënies së kontributit të kategorisë "*Ushqime të papërpunuara*", të dy kategoritë e ushqimeve vazhdojnë të përcaktojnë rreth 70% të normës totale të inflacionit.

Kategoritë e tjera vazhdojnë të karakterizohen nga norma të ulëta inflacioni, me gjithë luhatjet e çmimeve në disa nga mallrat e shërbimet përbërëse të tyre.

Tabelë 1. Kontributi i kategorive kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindje)

	T4:12	T1:13	T2:13	T3:13	T4:13	T1:14	T2:14	T3:14	T4:14
Ushqime të përpunuara (pp)	0.6	0.5	0.3	0.1	-0.1	-0.1	-0.2	-0.1	0.1
Bukë dhe drithëra (pp) *	0.0	0.1	0.1	0.1	0.0	-0.1	-0.1	-0.1	-0.1
Alkool dhe duhan (pp)	0.2	0.1	0.2	0.1	0.1	0.3	0.3	0.3	0.3
Ushqime të papërpunuara (pp)	1.0	1.7	2.0	1.5	1.5	1.6	1.3	1.5	0.8
Fruta (pp)	0.5	0.3	0.4	0.8	0.5	0.7	0.7	0.2	0.4
Perime(pp)	0.2	1.2	1.5	0.5	1.1	0.9	0.6	1.2	0.2
Shërbime (pp)	0.2	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.2
Mallra me çmime të rregulluara (pp)	0.1	0.1	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	-0.1	0.1
Lëndë djegëse dhe energji (pp)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Strehim (pp)	-0.2	-0.1	-0.1	0.0	0.3	0.3	0.2	0.1	0.1
Mallra konsumi joushqimor	0.5	0.0	-0.3	-0.4	-0.2	0.2	0.2	0.2	0.0
Mallra konsumi afatgjatë (pp)	0.2	0.1	0.1	0.0	0.0	-0.1	-0.1	0.0	0.0
Indeksi i Çmimeve të Konsumit (v/v %)	2.4	2.5	2.2	1.5	1.5	1.9	1.6	1.7	1.3

Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.
**Në tabelë janë paraqitur disa nga grupet kryesore të kategorive.*

Gjatë këtij tremujori, çmimet në kategorinë "*Mallra të konsumit joushqimor*" kanë pësuar rënie dhe, në muajin dhjetor, inflacioni dhe kontributi i saj u rikthyen në vlera negative. Çmimi i naftës, pëson rënie prej disa muajsh, si në tregun vendas dhe në atë botëror. Në mënyrë të veçantë, në muajin dhjetor, inflacioni vjetor i nëngrupit "karburante" shënoi një vlerë rreth -6%, duke e ulur kontributin e kësaj kategorie me 0.2 p.p..

Kategoria "*Mallra dhe shërbime me çmime të rregulluara*" u rikthye të shënojë vlera pozitive të inflacionit dhe të kontributit të saj në inflacionin total. Kjo rritje erdhi për shkak të rritjes me 22.2% të tarifave për studime universitare, dhe ka dhënë një kontribut shtesë me 0.2 p.p. në inflacionin total. Kategoria "*Shërbime*" pësoi një rritje të kontributit me 0.1%, kryesisht për shkak të rritjes së tarifave të komunikimit.

Grafik 4. Inflacioni vjetor sipas kategorive të mallrave dhe të shërbimeve (në përqindje)



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

3. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE

Presionet e përgjithshme inflacioniste rezultuan të dobëta gjatë vitit 2014. Në aspektin makroekonomik, nivelet e ulëta të inflacionit vazhdojnë të përcaktohen nga ecuria e dobët e kërkesës agregate, e cila nuk arrin të verë në shfrytëzim të plotë kapacitetet prodhuese të ekonomisë dhe krijon presione të dobëta për rritjen e pagave, të kostove të prodhimit dhe të marzheve të fitimit. Paralelisht me to, faktorët e ofertës kanë ardhur në zbehje gjatë tremujorit të fundit. Inflacioni i importuar ka qenë në rënie, si pasojë e rënies së çmimeve në tregjet botërore, ndërsa pritjet për inflacionin mbeten në nivele të ulëta historike.

Tkurrja e ekonomisë në tremujorin e dytë rezultoi e përkohshme dhe aktiviteti ekonomik u rrit me 3.3% në tremujorin e tretë. Nga ana e kërkesës, rritja ekonomike u mbështet nga kërkesa e brendshme private, ndërsa sektori publik dhe kërkesa e huaj nuk kontribuuan në rritje. Vlerësimet tona sugjerojnë një rritje disi më të ulët për tremujorin e katërt, ndonëse stimuli fiskal ka qenë në rritje në këtë periudhë. Në tërësi, për vitin 2014, Banka e Shqipërisë gjykon se ekonomia shqiptare ka shënuar një rritje ekonomike më të lartë se gjatë vitit paraardhës, por aktiviteti ekonomik në vend vijon të mbetet nën potencial.

Zhvillimet e pritura për të ardhmen do të ruajnë në përgjithësi tendencat e vëna re gjatë viit 2014. Ambienti i jashtëm ekonomik, i karakterizuar nga një ecuri e dobët ekonomike e vendeve partnere, nga tendenca dizinflacioniste në Eurozonë dhe nga prime të larta rreziku në tregjet financiare, nuk është favorizues për rritjen ekonomike dhe kthimin e inflacionit në objektiv. Megjithatë, parashikimet tona tregojnë për një rritje ekonomike në përmirësim progresiv gjatë viteve të ardhshme, të mbështetur nga gjallërimi i kërkesës së brendshme. Kjo e fundit do të ndihmohet dhe nga politika monetare lehtësuese e ndjekur nga Banka e Shqipërisë dhe kushtet më të mira të financimit të krijuara prej saj. Ekonomia shqiptare pritet të kthehet në potencial brenda disa tremujorësh, ndërsa inflacioni parashikohet të konvergojë në objektiv në afat të mesëm. Gjithsesi, Banka e Shqipërisë vlerëson se rreziqet rreth këtij parashikimi gjenden të zhvendosura më së shumti në kahun e poshtëm. Kthimi i qëndrueshëm i ekonomisë në potencial do të kërkojë ruajtjen e kahut stimulues të politikave makroekonomike, ndërsa rritja e qëndrueshme dhe afatgjatë e vendit do të kërkojë vazhdimin me intesitet të reformave strukturore.

3.1 AMBIENTI I JASHTËM I EKONOMISË

3.1.1 RRITJA EKONOMIKE DHE BALANCAT KRYESORE MAKROEKONOMIKE

Ekonomia botërore ka treguar ecuri pozitive dhe ritme më të larta rritjeje në gjysmën e dytë të vitit.[3] Dinamika e treguesve paraprakë dhe të tërthortë të tremujorit të fundit sugjeron se rritja ekonomike botërore do të jetë më e shpejtë dhe do të mbështetet kryesisht tek rritja në vendet e zhvilluara. Normat e papunësisë në shtetet e zhvilluara duket të kenë ndalur rritjen dhe shpesh kanë treguar rënie. Megjithatë, presionet inflacioniste janë zbutur dukshëm, si pasojë e rënies së vazhdueshme të çmimeve të lëndëve të para dhe energjetike. Parashikimet flasin për një PBB në rritje në vitin 2015, ndonëse me ritme të përmbajtura, ndërkohë që balanca e rreziqeve është e drejtuar për poshtë, si rezultat i tensioneve gjeopolitike në Evropën Lindore dhe në Lindjen e Mesme.

Tabelë 2. Disa prej treguesve kryesorë makroekonomikë

	Ndryshimi i PBB-së		Norma e papunësisë	Norma e inflacionit	
Shtetet	T3-14/T2-14	T3-14/T3-13	Nëntor-14	Dhjetor-14/ Nëntor-14	Dhjetor-14/ Dhjetor-13
ShBA	1.0	2.4	5.6[1]	-0.3[3]	1.3[3]
Eurozonë	0.2	0.8	11.5	-0.23	-0.2
Gjermani	0.1	1.2	5.0	0.0	0.2
Francë	0.3	0.4	10.3	0.1	0.1
Mbretëria e Bashkuar	0.7	3.0	5.9[2]	0.0	0.5
Japoni	-0.5	-1.2	3.5	-0.4[3]	2.4[3]

Burimi: BQE, FED, Eurostat dhe institutet statistikore përkatëse.
[1] Muaji dhjetor 2014; [2] muaji shtator 2014; [3] muaji nëntor2014.

EKONOMIA E EUROZONËS

Publikimi i fundit[4] i Eurostat-it për rritjen ekonomike në Eurozonë për tremujorin e tretë paraqiti një rritje tremujore prej 0.2% dhe vjetore prej 0.8%. Kontributi kryesor pozitiv në formimin e PBB-së erdhi nga konsumi i brendshëm, i cili u kthye në terren pozitiv pas një kohe të gjatë. Kategoria e investimeve rezultoi neutrale, ndërkohë që ajo e eksporteve neto ishte negative. Treguesit e fundit paraprijës së ecurisë së PBB-së për eurozonën, si dhe vlerësimet paraprake e indirekte mbi ecurinë e shitjeve, porosive të reja dhe prodhimit industrial, sugjerojnë rritje edhe në tremujorin e katërt, ndonëse ritmi do jetë i moderuar. Treguesit e besimit të biznesit dhe të konsumatorëve paraqiten më optimistë, duke i bërë më të balancuara pritshmëritë e agjentëve ekonomikë. Vëmendja e drejtuesve të BQE-së në këto muaj është fokusuar edhe tek ecuria rënëse e inflacionit. Normat e tij janë ulur dukshëm dhe parashikimet për vitin 2015 tregojnë se inflacioni do luhatet në nivele të ulëta përgjatë gjithë vitit. Në këto kushte, opsioni i ndjekjes së politikave të tjera lehtësuese nga ana e BQE-së (lehtësim sasior) duket më i afërt.

[3] *Këto vlerësime i referohen kryesisht raportit të fundit mujor të BQE-së, dhjetor 2014, dhe analizës së treguesve PMI kryesorë paraprijës për PBB-në nga Markit, 12 janar 2015.*
[4] *Second estimate for the third quarter of 2014, 05 dhjetor 2014.*

EKONOMIA E SHBA-SË

Ekonomia e ShBA-së ka përshpejtuar ritmin e rritjes në tremujorin e tretë të vitit, duke përforcuar idenë se ekonomia vendase ka kaluar një pikë kthese pas krizës ekonomike e financiare. Ecuria e aktivitetit ekonomik është diktuar nga rritja e shpenzimeve konsumatore dhe atyre të qeverisë federale, ndërsa rënia e investimeve private dhe shpenzimeve të qeverive lokale kanë frenuar disi rritjen ekonomike. Tkurrja e eksporteve është balancuar nga rënia e importeve. Të dhënat nga treguesit me frekuencë më të madhe, si shitjet me pakicë, indekset e aktivitetit prodhues dhe ato të tregut të punës, sugjerojnë se rritja ekonomike e shpejtë ka vazhduar edhe në tremujorin e katërt të vitit. Inflacioni gjatë kësaj periudhe ka qëndruar nën nivelin e shënjestruar nga Rezerva Federale.

EKONOMITË KRYESORE TË RAJONIT

Ekonomia **italiane** ka vazhduar në recesion në tremujorin e tretë të vitit. Ky është tremujori i tretë radhazi me rritje ekonomike tremujore negative. Kërkesa e ulët vendase, shpenzimet qeveritare dhe investimet kanë qenë tre faktorët me ndikim negativ në aktivitetin ekonomik, ndërsa rritja e kërkesës së huaj ka zbutur disi këtë efekt. Në ndarjen sektoriale të ekonomisë vendase, prodhimi bujqësor, prodhimi industrial dhe sektori i ndërtimit kanë shënuar tkurrje, ndërsa kontributi i sektorit të shërbimeve ka qenë neutral.

Ekonomia e **Greqisë** ka dalë nga recesioni në tremujorin e tretë të vitit, duke regjistruar një rritje tremujore pozitive për të parën herë që prej fillimit të krizës. Baza e ulët krahasuese e një viti më parë ka bërë që të ketë një rritje pozitive thuajse në të gjithë komponentët përbërës të PBB-së. Kështu, rritja e shpenzimeve konsumatore, e investimeve dhe e eksporteve neto, kanë kompensuar tkurrjen e shpenzimeve qeveritare në këtë tremujor. Megjithatë, situata në të ardhmen mbetet e paqartë, si pasojë e pasigurisë politike në vend.

Ekonomia **turke** ka vijuar të ngadalësojë ritmin e rritjes në tremujorin e tretë të vitit, duke treguar dobësimin e kërkesës së brendshme. Kështu, shpenzimet konsumatore dhe investimet private nuk kanë ndikuar në rritjen ekonomike, e cila është ushqyer nga shpenzimet e larta qeveritare dhe nga rritja e shpejtë e eksporteve. Importet neto, që llogariten me shenjë negative në rritjen ekonomike, shënuan rënie. Të dhënat paraprake nga tregtia, nga prodhimi industrial dhe nga indekset e besimit, sugjerojnë që rritja ekonomike ka qenë e ulët në tremujorin e katërt të vitit.

Aktiviteti ekonomik në **Maqedoni** ka mbajtur ritëm zgjerues edhe në tremujorin e tretë të vitit. Investimet totale, të shtyra në pjesën më të madhe nga investimet qeveritare, ishin kontribuuesi kryesor i rritjes. Eksportet neto dhe shpenzimet konsumatore kanë ngadalësuar ritmet e tyre të rritjes, duke kontribuar më pak në ecurinë e përgjithshme ekonomike. Në ndarjen sektoriale, prodhimi industrial është ngadalësuar, ndërsa sektori i ndërtimit ka treguar rritje të lehtë, pas disa tremujorësh stanjacioni. Të dhënat e tërthorta nga shitjet me pakicë dhe prodhimi sugjerojnë për një rritje ekonomike disi më të ulët në tremujorin e fundit të vitit.

Tabelë 3. Tregues ekonomikë për vendet e rajonit

Vendet	Ndryshimi i PBB-së	Inflacioni vjetor	Norma e papunësisë
	T3:14/T3:13	Dhjetor-14	Nëntor -14
Itali	-0.5	-0.1	13.4
Greqi	0.7	-2.5	25.8[2]
Maqedoni	4.1	-0.6	27.9[1]
Serbi	-3.6	1.7	17.6[1]
Kroaci	-0.5	-0.5	16.6
Turqi	1.7	8.2	10.4[2]
Kosovë	1.7[3]	-0.4	30.0[4]
Shqipëri	3.3	0.7	17.4[1]

[1] Vlera për T3 2014; [2] vlera për muajin tetor 2014; [3] vlera për T1 2014; [4] vlera për vitin 2013.

3.1.2 ECURIA E ÇMIMEVE TË PRODUKTEVE KRYESORE

Edhe gjatë tremujorit të katërt, çmimi i naftës për fuçi ka ndjekur trajektoren rënëse të filluar që në muajin gusht të këtij viti. Indeksi i Evropës për naftën, *Brent*, shënoi rënie të shpejtë, si në terma vjetorë (30.0%) ashtu edhe në ato tremujorë (25.0%). Një fuçi naftë në tregjet ndërkombëtare u tregtua me mesatarisht 62.4 dollarë, vlera më e ulët në këto 5 vitet e fundit. Rënia e vazhdueshme e çmimit reflektoi rritjen e vazhdueshme të prodhimit në SHBA, furnizimin e bollshëm edhe nga shtetet e tjera prodhuese, si dhe kërkesën e dobët për naftë në nivel botëror. Për sa i përket parashikimeve për vitin 2015 dhe atë 2016, mbështetur në raportin e *U.S Energy Administration Information*[5], çmimi mesatar për fuçi pritet të jetë përkatësisht 57.6 dhe 75 dollarë.

Grafik 5. Ndryshimi vjetor i çmimeve bazë (në përqindje)



Burimi: FMN, EIA.

Të udhëhequra nga ecuria e çmimit të naftës, çmimet e mallrave kryesore[6] u tkurrën me 20.2% në terma vjetorë dhe me 16.9% në terma tremujorë. Në të njëjtën kohë, çmimet e ushqimeve ranë me 7.4% në terma vjetorë dhe me 5.0% në ato tremujorë. Këto zhvillime u diktuan kryesisht nga forcimi i dollarit në tregjet valutore[7], oferta e gjerë për këto produkte dhe mungesa e presioneve nga ana e kërkesës. Për vitin 2015, çmimet mesatare të mallrave kryesore priten të qëndrojnë në nivele më të ulëta se ato për vitin 2014.

[5] *Të dhënat i referohen raportit mujor të EIA, janar 2015.*

[6] *Çmimet e mallrave kryesore dhe ato të ushqimeve i referohen indekseve mujore të publikuara nga FMN-ja.*

[7] *Mbështetur në indeksin nominal të publikuar nga FED-i, gjatë tremujorit të fundit 2014, dollari amerikan është forcuar me 6.0% në bazë tremujore ndaj shportës së monedhave të tjera kryesore në tregjet ndërkombëtare.*

3.1.3 POLITIKA MONETARE DHE NORMAT E INTERESIT

Bankat qendrore kryesore i kanë lënë të pandryshuara normat e tyre bazë të interesit, respektivisht në 0.05% BQE, në 0.15% Rezerva Federale, në 0.5% Banka e Anglisë dhe në 0-0.1% Banka e Japonisë.

Grafik 6. Normat bazë të interesit të disa bankave qendrore



Burimi: Bankat qendrore (BQE, Fed,BoJ dhe BoE).

Në tregjet e parasë së Eurozonës, normat euribor janë zvogëluar më tej këtë tremujor, ndërsa ato për dollarin amerikan (libor) kanë ruajtur të njëjtin nivel. Norma ditore eonia e tregut ndërbankar në euro është pozicionuar në terren negativ që prej muajit nëntor, duke reflektuar politikën lehtësuese të likuiditetit të BQE-së. Në tregjet e kapitaleve, *yield*-et e obligacioneve për shtetet e zhvilluara dhe me vlerësim maksimal (AAA) janë ulur sërish këto muaj, të influencuara kryesisht nga të dhënat e treguesve indirektë për ekonominë. Këta të fundit konfirmuan se rikthimi i rritjes së fortë ekonomike është larg. *Yield*-et e obligacioneve të shteteve me detyra konsolidimi fiskal (Italia, Portugali, Greqi) gjithashtu kanë regjistruar ulje të lehta, nën efektin e konfirmimit të politikës stimuluese monetare nga BQE-ja dhe arritjes së rezultateve në bilancet publike respektive. Në tregjet valutore, euro gjatë këtyre tre muajve është nënçmuar ndaj dollarit amerikan (5.7% t.m.t), ndaj renminbi kinez (6.4% t.m.t) dhe ndaj paundit britanik (0.6% t.m.t), ndërkohë që ka fituar terren ndaj jen-it japonez (3.5 t.m.t). Në terma mesatarë bilateralë, në muajin dhjetor, një euro u këmbye me 1.2331 dollarë amerikan, duke u nënçmuar 1.4% krahasuar me një muaj më parë dhe 10.2% me vitin e kaluar.

Grafik 7. Ecuria e disa treguesve financiarë në tregjet ndërkombëtare



Burimi: Bloomberg, Reuters.

3.2 PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO DHE ECURIA E KËRKESËS AGREGATE

Në linjë me vlerësimet dhe projeksionet tona, aktiviteti ekonomik iu rikthye normave pozitive të rritjes në tremujorin e tretë të vitit 2014. Zgjerimi i vlerës së shtuar në ekonomi ishte me bazë të gjerë, i vërejtur në thuajse të gjithë sektorët e ekonomisë. Nga ana e kërkesës agregate, komponenti kryesor i rritjes ekonomike vlerësohet të ketë qenë rritja e kërkesës së brendshme. Kushtet monetare stimuluese, rritja e besimit të agjentëve ekonomikë, si dhe reduktimi i primeve të rrezikut, kanë nxitur kërkesën e brendshme, ndërkohë që kërkesa e huaj ka rezultuar më e dobët se pritshmëritë. Tremujori i katërt pritet të karakterizohet nga një tablo përgjithësisht e ngjashme, por kërkesa private pritet të vijë në ngadalësim ndërsa stimuli fiskal në rritje.

Informacioni i ri ekonomik rrit lehtësisht vlerësimet tona për rritjen ekonomike të pritur gjatë vitit 2014. Nga ana tjetër, trajektoret e ecurisë së pritur për vitin 2015 e më tutje, nuk kanë pësur ndryshime të ndjeshme. Aktiviteti ekonomik pritet të shënojë përmirësime të mëtejshme në këtë periudhë, i mbështetur nga rritja e kërkesës së sektorit privat, nga përmirësimi i kushteve të financimit dhe nga përmirësimi në afat të mesëm i ekonomive të vendeve partnere. Gjithsesi, rreziqet që shoqërojnë këtë skenar mbeten në kahun rënës.

Vlera e shtuar reale nga sektorët e ekonomisë shënoi rritje vjetore me 3.3% gjatë tremujorit të tretë të vitit 2014. Performanca e ekonomisë rezultoi e përmirësuar në këtë tremujor, krahasuar me zgjerimin me 1.4% dhe tkurrjen me 0.4%[8] të regjistruar përkatësisht në tremujorët e parë dhe të dytë të vitit. Përtej efektit bazë të krahasimit me një tremujor të dobët një vit më parë, informacioni i disponuar sugjeron se kërkesa konsumatore ka ardhur në përmirësim në këtë periudhë, çka është reflektuar edhe në kontributin e lartë të sektorit të shërbimeve në rritjen e vlerës së shtuar. Përveç sektorit të shërbimeve, edhe sektori prodhues ka dhënë një kontribut pozitiv në rritjen ekonomike të këtij tremujori, duke krijuar një strukturë të balancuar të rritjes së prodhimit.

Në këndvështrimin e shpenzimeve, rritja ekonomike është mbështetur kryesisht nga kërkesa konsumatore dhe më pak nga aktiviteti investues i sektorit privat dhe atij publik. Përmirësimi i besimit në ekonomi, normat e ulëta të interesit dhe të inflacionit, rritja e punësimit, si dhe pagimi i detyrimeve të prapambetura, kanë mbështetur shpenzimet e sektorit privat gjatë tremujorëve të fundit. Sjellja e sektorit publik mbetet e orientuar drejt konsolidimit fiskal, por me nota më pak të theksuara gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit. Nga ana tjetër, kërkesa e huaj ka rezultuar e dobët dhe kontributi neto i shkëmbimeve ekonomike e tregtare me vendet partnere llogaritet të jetë negativ.

[8] *Publikimi i llogarive kombëtare për vitin 2013 ka sjellë rishikime të serisë tremujore të vlerës së shtuar për ekonominë.*

Grafik 8. PBB-ja dhe dinamika vjetore e komponentëve të kërkesës agregate



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Në balancë, informacioni i disponuar për tremujorin e katërt tregon për vijimësinë e normave pozitive të rritjes, por me një ritëm më të ulët se tremujorin paraardhës.[9] Në agregat, viti 2014 vlerësohet të shënojë një rritje ekonomike më të lartë se viti i kaluar.

Luhatjet e deritashme të rritjes ekonomike projektohen t'i lënë vendin një trendi rritës në horizontin afatmesëm. Kërkesa e brendshme pritet të mbështetet nga kushtet e lehtësuara monetare, nga përmirësimi i besimit dhe i kushteve të financimit dhe nga reduktimi i primeve të rrezikut. Kërkesa e huaj pritet të forcohet, në reflektim të rikuperimit të ekonomisë botërore, duke krijuar hapësira për rritjen e eksporteve shqiptare.

Megjithatë, rritja ekonomike afatmesme projektohet të jetë e ngadaltë në krahasim me vlerat historike, e kushtëzuar nga kapacitetet e lira në tregjet e kapitalit dhe të punës dhe nga rikuperimi i oreksit për rrezik në tregjet financiare dhe të kredisë për sektorin privat. Vazhdimi i reformave strukturore për të nxitur aktivitetin investues, për të adresuar problemet strukturore të tregut të punës dhe për të nxitur rritjen e produktivitetit e konkurrueshmërisë së eksporteve tona, do të siguronte kushtet e nevojshme për një rritje ekonomike të qëndrueshme dhe për zgjerimin e potencialit të ekonomisë sonë.

[9] *Analiza ekonomike dhe vlerësimet e kërkesës agregate për tremujorin e katërt janë mbështetur mbi treguesit e përditësuar fiskalë, të tregtisë së jashtme, të kredisë dhe të depozitave deri në muajin nëntor dhe të treguesve të besimit për tremujorin e katërt të vitit 2014.*

3.2.1 PRODHIMI SIPAS SEKTORËVE[10]

Me përjashtim të transportit, rritja vjetore e vlerës së shtuar u mbështet nga zgjerimi i aktivitetit në të gjitha degët e ekonomisë. Kontributin më të madh në zgjerimin e aktivitetit ekonomik e dha **sektori i shërbimeve**, me 1.9 pikë përqindje. Rritja e vlerës së shtuar në këtë sektor u ndikua nga zgjerimi i shpejtë i degës së tregtisë. **Sektori prodhues** kontribuoi me 1.4 pikë përqindje në rritjen e vlerës së shtuar totale. Aktivitetet e këtij sektori – ndërtimi, industria, dhe bujqësia - e rritën vlerën e shtuar në ekonomi përkatësisht me 0.8, 0.4 dhe 0.2 pikë përqindje. Rezultatet e vrojtimeve, siç dëshmohet nga tendenca rritëse e treguesit të ndjesisë ekonomike dhe e treguesve të tjerë të besimit, sugjerojnë se ecuria e aktivitetit ekonomik do të mbetet pozitive edhe në tremujorin e katërt të vitit 2014.

Grafik 9. Kontributet e sektorëve të ekonomisë në ecurinë e vlerës së shtuar dhe treguesit e besimit



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Ecuria e **sektorit të industrisë** rezultoi pozitive në tremujorin e tretë të vitit. Vlera e shtuar e aktivitetit industrial shënoi rritje vjetore me 2.4%, pas rënies me të njëjtën normë në tremujorin e dytë.

Dega e *industrisë nxjerrëse* vijoi të kontribuojë në masën më të madhe, me 1.9 pikë përqindje, në përmirësimin e performancës së sektorit të industrisë. Në tremujorin në analizë, vlera e shtuar nga dega e *industrisë përpunuese* shënoi gjithashtu një rritje vjetore 0.9%, e cila llogaritet të ketë kontribuar me 0.5 pikë përqindje në zgjerimin e industrisë. Treguesit e vrojtimeve në sektorin e industrisë kanë ndërprerë tendencat rritëse në tremujorin e katërt të vitit, duke sugjeruar për ngadalësim të aktivitetit në këtë sektor.

[10] *Ecuria tremujore e prodhimit në ekonomi analizohet në terma të vlerës së shtuar bruto reale, deri në tremujorin e tretë të vitit 2014. INSTAT-i publikoi të dhënat në 9 janar të vitit 2015. Vlerësimet tremujore të ecurisë ekonomike nga INSTAT-i nuk përmbajnë vlerësime me frekuencë tremujore të taksave dhe të subvencioneve mbi produktet. Për rrjedhojë, analiza tremujore nuk trajtohet në terma të prodhimit të brendshëm bruto. Diferencat në normat vjetore të ecurisë së vlerës së shtuar të degëve referuar në këtë raport, krahasuar me raportin e mëparshëm tremujor të politikës monetare, burojnë nga publikimi paraprak i vlerës së shtuar bruto vjetore për vitin 2013, por edhe përditësimi i të dhënave bazë të përdorura në vlerësim.*

Grafik 10. Kontributet e degëve në ecurinë e vlerës së shtuar në industri dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në këtë sektor



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Vlera e shtuar nga *dega e ndërtimit* shënoi një rritje vjetore me 7.5% në tremujorin e tretë të vitit, duke kontribuar me 0.8 pikë përqindje në rritjen reale të vlerës së shtuar në ekonomi. Ndryshimi i drejtimit të dinamikës së aktivitetit ndërtues, nga tkurrje e fortë në gjysmën e parë të vitit në ecuri pozitive në tremujorin e tretë, i atribuohet efektit bazë[11], rritjes së numrit të lejeve të ndërtimit[12] dhe efektit pozitiv në likuiditet të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura të qeverisë në fushën e infrastrukturës[13]. Analiza e vlerës së përafërt të lejeve të ndërtimit tregon se aktiviteti ndërtues rezultoi i zgjeruar kryesisht për ndërtesa për qëllime banimi e të tjera, por u ndikua pozitivisht edhe nga realizimi i punimeve inxhinierike në infrastrukturë.[14] Prirja rritëse e treguesve të vrojtimeve të bizneseve në sektorin e ndërtimit sinjalizon për vijim të zhvillimeve pozitive në këtë sektor edhe në tremujorin e katërt.

[11] *Zbatimi teknik i konceptit të efektit bazë analizon devijimet jo të zakonshme të normave tremujore/mujore të një treguesi ekonomik nga ritmi mesatar historik i tij për ndikimin e tyre në ecurinë e normave vjetore të treguesit. Rritja vjetore e vlerës së shtuar në ndërtim me 7.5% në tremujorin e tretë, nga rënia e fortë me 21.4% në tremujorin e dytë, mbart në një masë edhe ndikimin pozitiv të efektit bazë. Kjo pasi në tremujorin e tretë të një viti më parë, vlera e shtuar në ndërtim regjistroi rënie tremujore me 21.7%, ndjeshëm më e ulët se ritmi mesatar i rritjeve të shënuara në tremujorët e tretë për periudhën 2009–2012. Devijimi i saj kontribuon me kah të kundërt në rritjen vjetore të gjeneruar në tremujorin e tretë të vitit 2014.*

[12] *Numri i lejeve të ndërtimit miratuar në tremujorin e tretë për ndërtesa banimi ishte 98 dhe për ndërtesa të tjera 24. Lejet e akorduara në total, rreth 122, rezultuan në rritje krahasuar me lejet e miratuara në dy tremujorët e parë të vitit, 58 dhe 39 leje. Ky tregues ka pasur ecuri më të mirë krahasuar me periudhat përkatëse në vitet 2012 dhe 2013, por mbetet nën vëllimet historike. Të dhënat e lejeve të ndërtimit i referohen buletineve statistikore tremujore të publikuara nga INSTAT-i.*

[13] *Pagesat e realizuara nga qeveria për detyrimet e prapambetura ndaj bizneseve të përfshirë në realizimin e investimeve publike në infrastrukturë (si ndërtime dhe riparime rrugësh, shkollash etj.) rezultoi e lartë në muajt qershor dhe korrik të vitit 2014. Kjo mund të ketë ndikuar pozitivisht në aktivitetin e bizneseve që veprojnë në sektorin ndërtues në tremujorin e tretë.*

[14] *Punimet inxhinierike përfshijnë ndërtime të lidhura me infrastrukturën e transportit (si rrugë e autostrada), linjat e ujësjellësve, elektrike dhe telekomunikacionit, ndërtime në komplekset industriale e të tjera.*

Grafik 11. Ecuria e vlerës së shtuar dhe norma e shfytëzimit të kapaciteteve në ndërtim



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

HAPËSIRË INFORMUESE 1: ECURIA E ÇMIMEVE NË TREGUN E BANESAVE

Indeksi i Çmimeve të Banesave ka shënuar rritje të lehtë në terma nominalë gjatë tremujorit të fundit të vitit 2014. Në terma realë, i deflatuar me Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK), ky tregues mbeti i pandryshuar, pas rënies së shënuar gjatë tre tremujorëve të fundit. Ndërkohë, Indeksi i Qirasë, pas rënies së theksuar që shënoi në tremujorin e tretë të vitit, u rrit me 4.9% në terma realë në këtë tremujor.

Grafik 12. Indeksi i Çmimit të Banesave dhe raporti i tij ndaj Indeksit të Qirasë së Banesave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në tremujorin e katërt të vitit, raporti i indeksit të çmimeve ndaj qerasë regjistroi rënie krahasuar me një tremujor më parë, si dhe me një vit më parë, përkatësisht me 0.2 dhe 0.1 pikë përqindje. Ky tregues vijon të luhatet afër mesatares së gjashtë viteve të fundit.

Grafik 13. Ecuria e vlerës së shtuar në sektorin e bujqësisë, gjuetisë dhe pyjeve, si dhe kontributi i saj në ekonomi



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Aktivitetet e **bujqësisë, gjuetisë dhe pyjeve**, shënuan një rritje vjetore me 1.2% të vlerës së shtuar në tremujorin e tretë të vitit. Kjo rritje mbetet nën normën mesatare historike prej 4.6% të zgjerimit të sektorit bujqësor. Kushtet e motit nuk kanë qenë të favorshme, gjë që ka ndikuar nivelin e faktuar të prodhimit bujqësor në tremujorin e tretë.[15]

Sektori i shërbimeve vijoi të mbështesë rritjen e aktivitetit ekonomik në tremujorin e tretë të vitit. Vlera e shtuar nga degët e shërbimeve regjistroi rritje vjetore me 3.7%, duke ndjekur një trend rritës gjatë vitit. Kjo luhatje e dinamikës së shërbimeve mbi normën mesatare historike të rritjes prej 2.1%, i atribuohet kryesisht performancës më pozitive të degëve *të tregtisë* dhe *shërbimeve të tjera*. Më konkretisht, aktiviteti tregtar dhe shërbimet e tjera[16] kontribuan me përkatësisht me 1.6 dhe 1.1 pikë përqindje në rritjen e vlerës së shtuar në ekonomi. Ndërkohë, dega e transportit vijoi tkurrjen e fortë të nisur që në tremujorin e katërt të vitit 2013[17], duke ulur vlerën e shtuar në ekonomi me 1.1 pikë përqindje në tremujorin në analizë. Treguesit e besimit në sektorin e shërbimeve sugjerojnë për vazhdim të tendencave pozitive në këtë sektor edhe gjatë tremujorit të fundit të vitit 2014.

Grafik 14. Kontributet e degëve në ecurinë e vlerës së shtuar në shërbime dhe normat e shfrytëzimit të kapaciteteve në këtë sektor



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

[15] *Reshjet e shiut gjatë muajve qershor dhe korrik, kanë ndikuar negativisht prodhimin bujqësor.*

[16] *Aktivitetet e përfshira në shërbimet e tjera grupohen në: "Aktivitete financiare", "Aktivitete mbi pasuritë e patundshme, dhënien me qira dhe shërbime për ndërmarrjet", "Administrata publike dhe e mbrojtjes", "Arsimi", "Shëndetësia", "Shërbime të tjera kolektive, sociale dhe personale". Zhvillime më pozitive në këtë degë shfaqën shërbimet e shëndetësisë dhe shërbimet e tjera, sociale dhe personale.*

[17] *Dalja nga tregu e kompanisë shqiptare të fluturimit Bell Air në tremujorin e katërt të vitit 2013, dha një goditje negative në vlerën e shtuar të gjeneruar nga transporti ajror, e cila drejtoi ecurinë e aktivitetit transportues në total. Në tremujorin e fundit të vitit 2014, efekti statistikor negativ nga krahasimi me një bazë më të lartë gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2013, vlerësohet të shuhet në masën më të madhe. Kështu, goditja negative e transportit ajror pritet të zbehë në një masë më të ulët aktivitetin në degët e tjera të transportit.*

3.2.2 KËRKESA AGREGATE

Rritja e kërkesës agregate në tremujorin e tretë të vitit 2014 i atribuohet kryesisht zgjerimit të konsumit privat dhe, në një masë më të ulët, rritjes së investimeve private dhe konsumit të sektorit publik. Nga ana tjetër, kontributi i kërkesës së huaj neto llogaritet negativ, i ndikuar kryesisht nga zgjerimi i importeve në mallra e shërbime për këtë periudhë.

Të dhënat e deritanishme tregojnë për ecuri pozitive të kërkesës agregate në tremujorin e fundit të vitit, por me ritëm më të ulët se në tremujorin paraardhës. Struktura e rritjes ekonomike vlerësohet të mbetet e zhvendosur drejt kërkesës së brendshme, ndërkohë që kërkesa e huaj vlerësohet e dobët. Mbështetur në informacionin e disponuar dhe në analizat tona, Banka e Shqipërisë gjykon se rritja ekonomike për vitet 2014 e 2015 pritet të shënojë rritje progresive krahasuar me vitin paraardhës.

Konsumi privat kontribuoi pozitivisht në rritjen e kërkesës agregate të tremujorit të tretë të vitit. Rritja e shpenzimeve konsumatore reflektoi kryesisht rritjen e shpenzimeve për mallra të përditshme dhe më pak rritjen e shërbimeve dhe të mallrave të qëndrueshme, siç dëshmojnë tregues të llogarive kombëtare por edhe tregues të tjerë të tërthortë[18]. Indeksi i tregtisë me pakicë u rrit 6.4%, kryesisht i ndikuar nga kontributi i grupit të ushqimeve në tremujorin e tretë.[19]

Rritja e konsumit privat u mbështet nga rritja e besimit dhe e gatishmërisë së konsumatorëve për të shpenzuar një pjesë më të madhe nga të ardhurat e tyre. Ulja e pasigurisë dhe pritjet më optimiste për mundësitë e punësimit në të ardhmen, bazuar në të dhënat e vrojtimit të besimit të tremujorit të tretë, përbënë një stimul për rritjen e shpenzimeve konsumatore. Gjithashtu, në tremujorin e tretë, raporti i të punësuarve ndaj popullsisë në moshë pune u rrit me 1.8 pikë përqindje në krahasim me tremujorin e dytë. Lehtësimi i standardeve dhe i kushteve të kreditimit gjatë gjithë vitit të kaluar, veçanërisht për kredinë konsumatore, ka ndikuar gjithashtu pozitivisht vendimet e konsumatorëve për të shpenzuar. Prirja për të kursyer ka vazhduar edhe në tremujorin e tretë, por rritja vjetore e kursimeve të individëve në depozita dhe në letra me vlerë të qeverisë ka qenë më e ulët gjatë vitit 2014 në krahasim me një vit më parë.

Burimet e financimit të konsumit privat në tremujorin e tretë nuk regjistrojnë zhvillime të njëtrajtshme. Nga njëra anë, rritja e të ardhurave nga remitancat dhe kredia konsumatore, të mbrojtura nga norma të ulëta inflacioni, kanë mbështetur konsumin privat. Nga ana tjetër, pagat kanë pësuar rënie në degët kryesore të ekonomisë në tremujorin e tretë.

---

[18] *Bazuar në të dhënat e vlerës së shtuar bruto sipas metodës së prodhimit, vlera e shtuar në sektorët e shërbimeve, pa tregtinë, u rrit 0.73% në terma vjetorë, krahasuar me 1.1% mesatarisht në gjashtëmujorin e parë të vitit. Gjithashtu, importi në vlerë i autoveturave regjistroi rënie 5.1% në tremujorin e tretë, bazuar në të dhëna të tregtisë së jashtme.*

[19] *Indeksi i volumit të shitjeve në grupin "Ushqime, pije, duhan në njësi tregtare jo të specializuara dhe të specializuara" u rrit me 10.1% në terma vjetorë, duke dhënë kontributin më të madh në indeksin e volumit të shitjeve në tregtinë me pakicë.*

Grafik 15. Tregues të tërthortë të konsumit privat dhe burimeve të financimit të tij



*) Rritja vjetore për tremujorin e katërt të vitit 2014 është përafruar nga rritja vjetore e periudhën tetor-nëntor 2014.
Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Rritja e konsumit privat vlerësohet të jetë ngadalësuar në tremujorin e katërt, me zbehjen e optimizmit të konsumatorit. Pas rritjes në tremujorin e tretë, treguesi i besimit konsumator dhe balanca e blerjeve të mëdha regjistruan rënie në fund të vitit. Gjithashtu, bazuar në Vrojtimin e Aktivitetit Kreditues, lehtësimi i standardeve të kreditimit u ngadalësua në tremujorin e katërt. Tregues të tjerë të tërthortë sasiorë mbështesin rritjen e konsumit privat, veçanërisht rritja e ushqimeve të importuara dhe të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar[20]. Në ndryshim nga dinamika rënëse e tre tremujorëve të parë të vitit, importi i ushqimeve shënoi rritje 7.2% në periudhën tetor-nëntor, në terma realë vjetorë.

Rikuperimi i **investimeve private** ka vijuar në tremujorin e tretë të vitit, por ka kontribuar më pak në rritjen e kërkesës agregate, në krahasim me tremujorët paraardhës. Të dhëna nga ana e prodhimit sugjerojnë për kontribut pozitiv të investimeve, kryesisht në sektorin e ndërtimit. Gjithashtu, një kontribut pozitiv në rritjen e këtij komponenti kanë dhënë investimet në makineri dhe pajisje, importi i të cilave u rrit me 5.3%. Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në ekonomi u rrit me 1.9 pikë përqindje gjatë këtij tremujori, e ndikuar pozitivisht nga rritja e normës së shfrytëzimit të kapaciteteve në të gjithë sektorët përbërës.

Prirja e bizneseve për të kryer investime të reja është ndikuar pozitivisht nga rritja e besimit në ekonomi, nga përmirësimi i gjendjes financiare të bizneseve, dhe nga rritja e kredisë për qëllime investimi. Rritja e kontratave porositëse në sektorët e industrisë dhe të ndërtimit, si dhe ulja e pasigurisë për të ardhmen, kanë përbërë një shtysë tjetër për rritjen e investimeve.

[20] *Mbështetur në të dhënat për muajt tetor dhe nëntor të vitit 2014, të ardhurat nga TVSH-ja u rritën 8.1% në terma vjetorë. Kjo rritje ishte 29.3 dhe 13.4%, përkatësisht në tremujorin e parë dhe të dytë të vitit.*

Grafik 16. Tregues të tërthortë të investimeve private



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Të dhëna të tërthorta flasin për rritje të mëtejshme të investimeve private dhe kontribut pozitiv në kërkesën agregate në tremujorin e katërt. Importi i makinerive dhe pajisjeve u rrit me 27% në terma vjetorë për periudhën tetor-nëntor. Kredia e dhënë për qëllime investimi vazhdoi të rritet në këto dy muaj, pas kthesës pozitive të shënuar në tremujorin e tretë. Të dhëna nga vrojtimet e besimit mbështesin rritje të investimeve private, veçanërisht për sektorin e ndërtimit. Në afat më të gjatë, ecuria e këtij përbërësi të kërkesës agregate do të varet nga shpejtësia e përmirësimit të mëtejshëm të kërkesës agregate dhe e lehtësimit të kushteve të financimit.

Treguesit fiskalë dhe politika fiskale

Rritja e borxhit publik dhe përkeqësimi i mëtejshëm i pozicionit fiskal gjatë viteve të fundit, ka bërë të domosdoshëm ndryshimin e kahut të politikës fiskale, në funksion të ruajtjes së qëndrueshmërisë së financave publike. Politika fiskale konsoliduese për vitin 2014, e shprehur në ngushtim të deficitit buxhetor, është arritur kryesisht në sajë të rritjes së të ardhurave buxhetore. Megjithatë, konsolidimi fiskal dhe mënyra e realizimit të tij nuk kanë qenë të njëtrajtshme gjatë vitit. Në gjysmën e parë të vitit, deficiti buxhetor është tkurrur ndjeshëm, i nxitur si nga ecuria e të ardhurave, ashtu edhe nga ajo e shpenzimeve buxhetore[21]. Në tremujorin e tretë, madhësia e konsolidimit fiskal u moderua krahasuar me gjysmën e parë të vitit, pasi në këtë tremujor ky proces u mbështet vetëm nga rritja e të ardhurave buxhetore. Ndërkohë, rritja e shpenzimeve buxhetore në tremujorin e fundit të vitit pritet të gjenerojë një stimul pozitiv fiskal.

Grafik 17. Orientimi i politikës fiskale, i përafruar nga ndryshimi i deficitit primar*



*Stimuli fiskal është përafruar nga ndryshimet e raporteve të deficitit primar për një periudhë 12-mujore ndaj PBB-së, krahasuar me një vit më parë. Çdo vlerë në grafik reflekton ndryshimin për 12 muajt e fundit kalendarikë, krahasuar me 12-mujorin e mëparshëm. Ndryshimet pozitive në këto raporte tregojnë stimul pozitiv fiskal, ndërkohë që diferencat negative sinjalizojnë konsolidim fiskal.

Burimi: Ministria e Financave, INSTAT, llogaritje të stafit.

[21] *Kjo pjesë e vitit reflekton gjithashtu dhe efektin statistikor të bazës krahasuese.*

Trajektorja që kanë ndjekur shpenzimet buxhetore që përafrojnë konsumin final dhe formimin bruto të kapitalit fiks të qeverisë, sugjeron kontribut negativ në rritjen e kërkesës agregate gjatë gjysmës së parë të vitit. Ndërkohë, ky kontribut vlerësohet të jetë pozitiv për gjysmën e dytë të vitit, kryesisht në sajë të përqendrimit të lartë të shpenzimeve kapitale në tremujorin e fundit të vitit.

Pas gjashtëmujorit të parë të vitit, ritmet e rritjes së shpenzimeve buxhetore kanë kaluar në territor pozitiv vlerash, për t'u përshpejtuar drejt fundit të periudhës. Kështu, për periudhën 11-mujore, shpenzimet totale ishin rreth 5% më të larta në terma vjetorë nominalë. Për të njëjtën periudhë, shpenzimet korrente u rritën me rreth 1.6%, ndërsa ato kapitale ishin 24.1% më të ulëta krahasuar me një vit më parë. Kontribut të lartë (me rreth 7.5 pp) në rritjen e totalit të shpenzimeve gjatë 11-mujorit ka dhënë shlyerja e detyrimeve të prapambetura, duke kompensuar plotësisht efektin negativ kumulativ të shpenzimeve për investime publike. Duke përjashtuar shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, shpenzimet buxhetore gjatë 11 muajve janë rreth 343.9 miliardë lekë, ose 2.6% më të ulëta nga një vit më parë[22].

E parë sipas tremujorëve, tabloja fiskale paraqet mjaft luhatje brenda vitit 2014. Kështu, pas një tkurrjeje në dy tremujorët e parë, totali i shpenzimeve në tremujorin e tretë të vitit u rrit me rreth 12% në terma vjetorë, si pasojë e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, si edhe niveleve më të larta të shpenzimeve korrente. Ndërkohë, në dy muajt e fundit, shpenzimet u rritën me rreth 25.7% nga e njëjta periudhë një vit më parë, kryesisht në sajë të shpenzimeve kapitale dhe operative më të larta.

Grafik 18. Ndryshimi vjetor i totalit të shpenzimeve 3-mujore, sipas kontributeve të zërave kryesorë (majtas), dhe ndryshimet vjetore (për flukset 3-mujore) të zërave kryesorë të shpenzimeve (djathtas)



Burimi: Ministria e Financave.

[22] *Deri në fund të muajit nëntor janë shlyer rreth 26.5 miliardë lekë detyrime të prapambetura. Pothuajse gjysma e tyre konsiston në shlyerjen e detyrimeve tatimore. Ndërsa rreth 33% e tyre përfaqësohet nga detyrimet e prapambetura në infrastrukturë.*

Në ndryshim nga shpenzimet, të ardhurat buxhetore kanë regjistruar ritme të larta dhe të qëndrueshme rritjeje përgjatë gjithë periudhës. Deri në fund të 11-mujorit të parë, të ardhurat buxhetore ishin rreth 329.2 miliardë lekë, ose 12.6% më të larta nga një vit më parë. Rritja e totalit të të ardhurave i dedikohet pothuajse tërësisht të ardhurave me karakter tatimor.

Niveli i lartë i të ardhurave përgjatë 11-muajve të parë të vitit reflekton kombinimin e disa faktorëve. *Së pari*, ndryshimet në legjislacionin tatimor për vitin 2014[23] vlerësohet të kenë përmirësuar dinamikën e të ardhurave tatimore gjatë këtij viti. Kështu, në 11 muajt e parë të këtij viti, të ardhurat nga tatimi mbi fitimet e kompanive, akcizat, të ardhurat nga taksat kombëtare, si edhe të ardhurat nga pushteti lokal, u rritën përkatësisht me 42.2%[24], 15.9%, 16.9% dhe 14.6% në terma vjetorë. Rritja e regjistruar për këta katër zëra ka formuar rreth 49% të rritjes së të ardhurave tatimore gjatë këtij viti. *Së dyti*, formalizimi më i lartë i ekonomisë, si edhe përmirësimi i eficiencës në mbledhjen e të ardhurave tatimore kanë drejtuar në një masë të madhe rritjen e të ardhurave tatimore gjatë kësaj periudhe. Një prej indikatorëve që sugjeron eficiencë në rritje të administrimit tatimor është produktiviteti i TVSh-së, i cili është përmirësuar nga një vit më parë[25]. Të ardhurat e mbledhura nga TVSh-ja janë rritur me rreth 14.1% për 11 muajt e parë të vitit 2014, duke mbartur në të njëjtën kohë rreth 42% të rritjes të të ardhurave tatimore. Ky zë, ndryshe nga vitet e tjera, është ndikuar pozitivisht si nga TVSh-ja mbi importin e mallrave, ashtu edhe TVSh-ja e mbledhur mbi prodhimin e mallrave e shërbimeve në vend. Kështu, kjo e fundit për 11 muajt e parë të vitit ka kontribuuar me rreth 3.8 pikë përqindje në rritjen e totalit të të ardhurave nga TVSh-ja[26]. Pjesa më e lartë e rritjes së të ardhurave nga TVSh-ja e brendshme ka ardhur nga sektori i tregtisë dhe ai i shërbimeve. Në të njëjtën kohë, këta dy sektorë kanë mbartur rreth 80% të zgjerimit të bazës tatim-paguese gjatë kësaj periudhe[27], pavarësisht rregullimeve ligjore të pandryshuara nga një vit më parë. Nga ana tjetër, TVSh-ja mbi importin e mallrave kontribuoi me rreth 10.7 pp në rritjen e totalit të TVSh-së, duke reflektuar rritjen me rreth 8.6% të importeve për 11 muajt e parë të vitit. *Së treti*, dinamika e të ardhurave gjatë vitit 2014 reflekton pjesërisht dhe efektin statistikor të krahasimit me një vit më parë, përgjatë të cilit të ardhurat regjistruan ritme negative rritjeje vjetore.

---

[23] *Ndryshimet kryesore në paketën fiskale të vitit 2014 kanë konsistuar në: rritje të normës së tatimit mbi fitimin në 15% (nga 10%); rritje e akcizës për mallrat ekzistuese, si edhe zgjerim i bazës së kësaj takse; rritje e taksës së qarkullimit të automjeteve me benzinë e gazoil, me 10 lekë/litër nga një vit më parë; ndryshime në përjashtimet prej TVSh-së, por normë e pandryshuar e TVSh-së mbi furnizimet e mallrave dhe shërbimeve; rritje e taksave mbi pasurinë.*

[24] *Në tërësi për gjithë bizneset, fitimet për vitin 2014 të korrektuara për normën e tatimit, vlerësohen më të ulëta nga 11-mujori 2013, me rreth 5.1%.*

[25] *Ky indikator që vlerësohet sipas formulës: Produktiviteti = (Të ardhura TVSh)/PBB*1/τ (ku τ është norma e TVSh-së), gjatë 3 tremujorëve të parë të vitit 2014, është përmirësuar në 0.44, nga 0.41 që vlerësohej mesatarisht në vitin 2013.*

[26] *Në vitet e mëparshme ky zë ka dhënë kontribut negativ në TVSh-në totale.*

[27] *Numri i bizneseve të përfshira në skemën e TVSh-së, u rrit me 11.6% nga një vit më parë, ku pjesa më e madhe e tyre ishin biznese që performonin në sektorin e shërbimeve e atë të tregtisë.*

Grafik 19. Ndryshimi vjetor i të ardhurave 3-mujore, sipas kontributeve të zërave kryesorë (majtas), dhe ndryshimet vjetore (për flukset 3-mujore) të zërave kryesorë të të ardhurave (djathtas)



Burimi: Ministria e Financave.

Deficiti buxhetor për 11 muajt e parë të vitit 2014 rezultoi rreth 41.3 miliardë lekë, ose rreth 35.1% nën nivelin e programuar për këtë periudhë kohore. Diferenca me planin është pasojë e mosrealizimit sipas skedulit të programuar për disa prej zërave të shpenzimeve buxhetore. Në terma vjetorë, deficiti buxhetor për 11-mujorin ka regjistruar një ngushtim prej 31.9%. Dinamika e deficitit buxhetor nuk ka qenë e njëjtë përgjatë tremujorëve. Ngushtimi i tij ka qenë më i theksuar në gjysmën e parë të vitit, duke reflektuar në një masë të lartë efektin e bazës krahasuese me një vit më parë. Në tremujorin e tretë, reduktimi i deficitit buxhetor u moderua krahasuar me dy tremujorët paraardhës. Ndërkohë, në tremujorin e fundit të vitit pritet një rritje vjetore e deficitit buxhetor, duke reflektuar trajektoren rritëse të shpenzimeve buxhetore të kësaj periudhe[28].

Grafik 20. Deficiti buxhetor kumulativ në përqindje të PBB-së (majtas) dhe instrumentet e financimit të tij sipas tremujorëve, në mld lekë (djathtas)



Burimi: Ministria e Financave, INSTAT, llogaritje të stafit.

[28] *Vetëm në muajt tetor-nëntor, shpenzimet totale u rritën me rreth 25.7% nga e njëjta periudhë një vit më parë, të nxitura kryesisht prej shpenzimeve kapitale.*

Financimi i deficitit buxhetor është kryer si nga burimet e brendshme, ashtu edhe ato të huaja. Zërin kryesor në financimin e brendshëm të deficitit e përbën emetimi i instrumenteve të borxhit në tregun e brendshëm të letrave me vlerë të qeverisë. Instrumentet afatgjata kanë pasur peshën më të lartë në shtimin e portofolit të letrave me vlerë të qeverisë përgjatë kësaj periudhe, duke përmirësuar profilin e shlyerjes së borxhit dhe vulnerabilitetet fiskale në të ardhmen. Nga ana tjetër, huamarrja e huaj, e cila përbëhet kryesisht nga kredia e disbursuar prej FMN-së (për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura), ka qenë një tjetër instrument kryesor në financimin e deficitit buxhetor gjatë këtij viti.

Kërkesa e huaj dhe tregtia e jashtme

Grafik 21. Kontributi i eksporteve neto në kërkesën agregate (në pikë përqindje)



Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT.

Të dhënat mbi sektorin e jashtëm të ekonomisë për tremujorin e tretë të vitit, tregojnë për një vijimësi të zgjerimit të deficitit të eksporteve reale neto për të gjashtin tremujor radhazi. Norma vjetore e thellimit të deficitit rezultoi rreth 18%. Në terma të ndikimit në ekonomi, ecuria e regjistruar vlerësohet të ketë dhënë një kontribut negativ prej 3.8 pikësh përqindjeje në ndryshimin vjetor të kërkesës agregate. Për tremujorin e fundit të vitit, parashikimet tona janë për një kontribut minimal negativ të eksporteve reale neto në ecurinë e kërkesës agregate, për ta mbyllur vitin me një kontribut mesatar prej -1.5 pikësh përqindjeje.

Të dhënat më të fundit mbi ecurinë e eksporteve neto për tremujorin e fundit të vitit përfshijnë vetëm komponentin e tregtisë në mallra për muajt tetor e nëntor. Deficiti tregtar në mallra për këto dy muaj u zgjerua me rreth 17.2% në nivel vjetor. Ndikimin më të qenësishëm në këtë ecuri e ka dhënë zgjerimi i përshpejtuar i importit. Ndërkohë, eksporti i mallrave është rritur me ritme të ulëta. Aktiviteti tregtar për periudhën tregon për një zgjerim prej rreth 6.5% të flukseve tregtare, krahasuar me të njëjtit muaj të një viti më parë. Raporti i mbulimit të importeve prej eksporteve ishte në nivelin 43.5%, ose rreth 3.5 pikë përqindje më i ulët se një vit më parë.

Gjatë muajve tetor e nëntor, eksporti i mallrave në vlerë u rrit me rreth 0.5% në nivel vjetor. Sipas të dhënave të detajuara të tregtisë së jashtme në mallra, kontributin kryesor në këtë ecuri e ka dhënë zgjerimi vjetor i eksportit të kategorisë "*Tekstile dhe këpucë*" me rreth 20.2%. Në këtë kategori përfshihen mallrat për eksport me material porositësi. Kontribut tjetër të rëndësishëm pozitiv dha edhe kategoria "*Ushqim, pije dhe duhan*", eksporti i të cilës ishte rreth 23% më i lartë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Brenda kësaj kategorie, rritja e përshpejtuar e eksportit të mallrave bujqësore udhëhoqi ecurinë e regjistruar. Në anën tjetër, eksporti i produkteve të kategorisë "*Materiale ndërtimi dhe metale*" është zvogëluar në nivel vjetor, i ndikuar prej rënies së çmimit të metaleve në tregjet ndërkombëtare. Megjithatë,

Grafik 22. Orientimi i importeve dhe eksporteve sipas kategorive
(vlera në milionë lekë)



Burimi: INSTAT.

kontributin më të madh negativ në ecurinë e eksporteve në vlerë prej rreth 7 pikësh përqindjeje, e dha rënia e përshpejtuar e eksportit të kategorisë "*Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike*". Në këtë kategori, zvogëlimi i përshpejtuar i çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare[29] ka ndikuar si në rënien e vlerës, ashtu edhe në vëllimin e naftës së eksportuar.

Aktiviteti importues shënoi një rritje prej rreth 9.3% në terma vjetorë gjatë muajve tetor e nëntor. Përcaktuesi kryesor i kahut të ecurisë vjetore të importeve totale ishte zgjerimi me rreth 27% i importit të mallrave të përfshira në kategorinë "*Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi*". Dinamikë të ngjashme ka shfaqur edhe eksporti i kategorisë "*Materiale ndërtimi dhe metale*", i cili u zgjerua me rreth 18% në bazë vjetore. Ecuria e importit të këtyre kategorive jep një pasqyrim të tërthortë të ecurisë së konsumit dhe të investimeve në vend përgjatë tremujorit të fundit të vitit. Pritshmëritë për vijimësinë e aktivitetit dinamik në industritë që punojnë me material porositësi për muajt në vazhdim përforcohet nga ruajtja e prirjes rritëse të importit të mallrave bazë që lidhen me prodhimin në këto industri. Ndërkohë, ndonëse importi në terma vjetorë i energjisë elektrike është rritur për këto dy muaj, importi në total i kategorisë "*Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike*" është zvogëluar. Ashtu si edhe tek performanca e eksporteve, rënia e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare ka rezultuar në import më të ulët në vlerë.

Aktiviteti eksportues i vendit vijon të mbështetet kryesisht në partnerë tregtarë si Italia, Malta, Kosova, Spanja, Greqia dhe Turqia. Në anën tjetër, origjina e produkteve të importuara prej vendit tonë vijon të mbetet më e larmishme, ku vendet e BE-së zënë peshën kryesore ndaj totalit.

[29] *Çmimi i naftës për fuçi në tregjet ndërkombëtare ra me mesatarisht 23% gjatë muajve tetor e nëntor, ndërsa çmimi mesatar për fuçi për naftën shqiptare ra me rreth 21.1%.*

HAPËSIRË INFORMUESE 2: ZHVILLIMET NË BILANCIN E PAGESAVE NË TREMUJORIN E TRETË 2014

Pozicioni neto i llogarisë korrente regjistroi një deficit prej 316.4 milionë eurosh në tremujorin e tretë të vitit 2014, duke ndjekur një prirje zgjeruese për të katërtin tremujor radhazi. Gjatë tremujorit në analizë, deficiti i llogarisë korrente shënoi rritje me rreth 66.2% në nivel vjetor dhe u vlerësua në nivelin 12.8% ndaj PBB-së nominale.

Sipas zërave përbërës të llogarisë korrente, ashtu si edhe gjatë gjysmës së parë të vitit, kontribut të kahut zgjerues kanë dhënë përkeqësimi i deficiteve të eksporteve neto dhe të të ardhurave parësore. Ndërkohë, zëri i të ardhurave dytësore, i cili u rrit lehtë krahasuar me vlerën e një viti më parë, dha ndikim të kahut ngushtues.

Këtë tremujor, kërkesa e huaj nuk ndihmoi në ruajtjen e prirjes rritëse të eksportit të mallrave dhe të shërbimeve. Prirje të ngjashme shfaqën edhe importet e mallrave dhe shërbimeve, por ritmet e rënies ishin më të moderuara krahasuar me ato të eksporteve. Bilanci i llogarisë së të ardhurave parësore qëndroi në territor negativ për të tretin tremujor radhazi, duke e thelluar më tej deficitin e regjistruar krahasuar me gjysmën e parë të vitit. Në anën tjetër, gjatë këtij tremujori është regjistruar një rritje prej rreth 3.0% e të ardhurave dytësore, ku vlen të theksohet rritja vjetore e dërgesave prej emigrantëve me rreth 1.9%.

Flukset hyrëse neto në llogarinë kapitale u rritën në 20.7 milionë euro, nga 15 milionë euro që ishin gjatë tremujorit të tretë të vitit të kaluar. Flukset neto në llogarinë financiare u dyfishuan krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë, duke financuar 44.5% të deficitit të llogarisë korrente. Investimet e huaja direkte neto këtë tremujor u zvogëluan me rreth 38.5% në nivel vjetor[30]. Në anën tjetër, investimet e tjera neto u vlerësuan në zgjerim të detyrimeve me rreth 91.6 milionë euro, si rrjedhojë e rritjes së detyrimeve në formë borxhi të qeverisë qendrore.

Bilanci i përgjithshëm i pagesave, në tremujorin e tretë të vitit 2014, rezultoi me rritje të mjeteve të rezervës valutore me rreth 155.1 milionë euro. Në fund të muajit shtator, stoku i rezervës valutore ishte rreth 2.21 miliardë euro, nivel ky i mjaftueshëm për mbulimin e 5.3 muajve importi mallrash dhe shërbimesh dhe për mbulimin e 182% të borxhit të jashtëm afatshkurtër.

[30] *Vlerësimi i investimeve të huaja direkte me frekuencë tremujore gjatë vitit mbështetet mbi të dhënat që merren nga bankat dhe nuk përfshin informacionin mbi huamarrjen/huadhënien në marrëdhënien e investimit të huaj direkt në Shqipëri. Ky informacion merret vetëm përmes vrojtimit vjetor të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) pranë ndërmarrjeve, i cili publikohet në muajin shtator të vitit pasardhës. Si rezultat i të dhënave që merren nga ky vrojtim, kryhet rishikimi i vlerave të IHD për secilin tremujor. Kështu, vlerat e IHD-ve për secilin tremujor të vitit 2014 do të rishikohen pas vrojtimit të IHD-ve për vitin 2014*

Tabelë 4. Tregues të bilancit të pagesave

	T2 '13	T3 '13	T4 '13	T1 '14	T2 '14	T3 '14
Llogaria Korente (në milionë euro)	-285.0	-190.4	-336.2	-260.8	-324.6	-316.4
vmv	13.2	-23.2	63.3	16.7	13.9	66.2
/ PBB-së	-10.9	-8.2	-13.4	-11.1	-12.2	-12.8
Mallra dhe shërbime	-442.5	-394.9	-518.1	-396.8	-468.8	-459.8
Eksporte, f.o.b.	805.6	981.0	960.3	609.7	753.0	842.1
Importe, f.o.b.	1248.1	1375.9	1478.4	1006.5	1221.8	1301.8
Udhëtime - neto	-31.5	26.1	34.0	-21.8	10.6	32.0
Të ardhura parësore	-11.0	22.2	0.0	-7.1	-28.6	-44.5
Kredi	35.7	40.2	33.4	29.2	25.8	28.3
Debi	46.7	18.0	33.4	36.3	54.3	72.8
Të ardhura nga IHD-neto	-20.1	6.2	6.9	-15.9	-31.4	-51.3
Të ardhura dytësore	168.4	182.3	181.9	143.0	172.9	187.8
Kredi	200.5	216.5	213.5	170.2	201.7	221.0
Debi	32.0	34.2	31.6	27.3	28.8	33.2
Dërgesa nga emigrantët (neto)	129.6	152.5	140.1	115.9	134.8	155.4
Llogaria kapitale	4.8	15.0	18.2	22.5	15.3	20.7
Huamarrje neto/Huadhënie neto	-280.2	-175.4	-318.0	-238.3	-309.3	-295.8
Llogaria Financiare	-262.4	-70.9	-226.1	-231.3	-225.4	-140.7
vmv	213.8	78.4	-16.2	82.5	-14.1	98.5
/ PBB-së	-10.0	-3.0	-9.0	-9.8	-8.5	-5.7
Investime direkte	-270.5	-307.0	-231.2	-192.6	-144.5	-188.9
Investime portofoli	104.4	6.2	-18.1	12.8	12.3	-14.2
Derivativë financiarë	1.1	0.0	-2.4	0.0	0.0	0.0
Investime të tjera	-183.8	195.4	18.6	-11.1	-115.8	-91.6
Mjetet e rezervës	86.4	34.5	7.1	-40.3	22.5	154.0
Gabime dhe harresa	17.8	104.5	91.9	7.0	83.9	155.1
Huamarrje neto/Huadhënie neto	-280.2	-175.4	-318.0	-238.3	-309.3	-295.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.3 GJENDJA CIKLIKE E EKONOMISË, PAGAT, KOSTOT E PUNËS DHE PRIRJET E INFLACIONIT

Presionet inflacioniste nga ekonomia reale mbeten të dobëta. Kërkesa e brendshme vijon të rritet nën potencialin e ekonomisë, në sinkronizim me dobësinë ciklike të partnerëve tanë kryesorë. Kapacitetet e pashfrytëzuara në tregun e punës e të kapitalit reflektohen në presione të dobëta për rritjen e pagave dhe të kostove të prodhimit, si dhe në nivele të ulëta të inflacionit bazë.

Projeksionet tona tregojnë se inflacioni do të kthehet pranë objektivit të Bankës së Shqipërisë në një horizont kohor afatmesëm, në përputhje me mbylljen graduale të hendekut negativ të prodhimit dhe me kohëvonesat e transmetimit të politikës monetare.

Normat e ulëta të inflacionit dhe të prirjeve kryesore të tij tregojnë se zhvillimet e tyre janë diktuar jo vetëm nga goditje pozitive nga ana e kostove, por edhe nga presione të dobëta nga ana e kërkesës. Vlerësimet tona tregojnë se hendeku i prodhimit mbeti negativ edhe gjatë vitit 2014, ndonëse me një tendencë drejt mbylljes. Ky vlerësim mbështetet edhe nga të dhënat e reja nga tregu i punës për tremujorin e tretë dhe nga vrojtimet e besimit

për tremujorin e katërt. Shkalla e papunësisë u reduktua me rreth 0.3 pikë përqindje, duke qëndruar në nivelin 17.4%.[31] Gjithashtu, bizneset raportojnë për një shfrytëzim më të madh të kapaciteteve prodhuese në dy tremujorët e fundit të vitit. Megjithatë, norma e shfrytëzimit të kapaciteteve mbetet nën normën mesatare historike dhe shkalla e papunësisë vijon të ruajë nivele të larta. Këto zhvillime gjenerojnë presione të ulëta për rritjen e pagave, kostove të punës dhe të prodhimit në ekonomi. Të ndikuara edhe nga ecuria e inflacionit, pritjet e agjentëve ekonomikë për të mbeten të zhvendosura në kahun e poshtëm.

Grafik 23. Hendeku i prodhimit* dhe kontributi i inflacionit bazë (majtas); norma e papunësisë (djathas)



Shënim: Seria e vlerësuar e hendekut të prodhimit, është shëshuar duke zbatuar mesataren lëvizëse me katër terma.
Burimi: Vlerësime të Bankës së Shqipërisë; INSTAT.

Produktiviteti, pagat, kostot e punës[32]

Rritja relativisht e lartë e indeksit të punësimit gjatë 9-mujorit të parë të vitit 2014[33], përballë dinamikës pozitive por të moderuar të rritjes së aktivitetit ekonomik, u reflektua në dinamikën negative të indeksit të produktivitetit të punës në sektorët jobujqësorë. Ndryshimi vjetor i këtij treguesi në tremujorin e tretë ishte -7.2%. Megjithatë, rënia e tij gjatë këtij tremujori ishte ndjeshëm më e ulët në krahasim me mesataren e gjashtëmujorit të parë të vitit, për shkak të rritjes më të lartë të vlerës së shtuar.

Në të njëjtin tremujor, treguesi i pagës mesatare në ekonomi thelloi prirjen rënëse të nisur në fillim të vitit 2014.[34] Ky tregues shënoi rënie vjetore me

[31] *Të dhënat për tregun e punës mbulohen nga Anketa e Forcës së Punës dhe nga statistikat afatshkurtra, publikuar nga INSTAT-i. Shkalla e papunësisë është raporti i numrit të të papunëve kundrejt forcës së aftë për punë.*

[32] *Treguesit e produktivitetit të punës dhe të kostove të punës për njësi të prodhuar, janë tregues të përafruar, të llogaritur nga Banka e Shqipërisë, mbi të dhënat e Statistikave afatshkurtra të T3'2014 (INSTAT). Në përllogaritjen e tyre përfshihen: indeksi i punësimit, i xhiros dhe i fondit të pagave, për aktivitetin jobujqësor.*

[33] *E cila ka reflektuar në një masë të konsiderueshme reformën e qeverisë për të formalizuar tregun e punës.*

[34] *Treguesi i pagës në ekonomi, referuar edhe nën termin "indeksi i pagës mesatare", është llogaritur si raport i indeksit të fondit të pagave me indeksin e numrit të punonjësve. Burimi: Statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve ekonomike SASh, INSTAT.*

rreth 5% dhe 6.6% në terma norminalë dhe realë në këtë periudhë. Rënia e treguesit të pagës për sektorin privat ka qenë me bazë të gjerë, e vërejtur në degët kryesore të ekonomisë si industri, ndërtim dhe shërbime.

Grafik 24. Treguesit e pagave në sektorët e ekonomisë dhe tregues të produktivitetit



Burim: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Ecuria e pagave reale dhe e produktivitetit të punës u reflektua në frenim të dukshëm të ritmeve vjetore të treguesit të kostove të punës për njësi të prodhuar (0.6%).

Prirje afatgjata të inflacionit dhe goditjet afatshkurtra mbi të

Tendenca në rënie e hendekut negativ të prodhimit në tremujorin e tretë të vitit 2014, ka gjetur pasqyrim në vlerat më të rritura të inflacionit afatgjatë dhe atij të brendshëm. Inflacioni bazë vjetor për këtë tremujor rezultoi rreth 0.34%, duke u rifutur në zonën pozitive. Megjithë reduktimin e dukshëm të inflacionit total vjetor në muajin dhjetor të këtij viti, inflacioni bazë rezultoi i njëjtë me atë të muajit paraardhës (0.4%). Gjithashtu, inflacioni vjetor i sektorit të patregtueshëm të IÇK-së për tremujorin e katërt rezultoi 2.1%, më i lartë për shkak të rritjes vjetore të çmimeve të disa shërbimeve.[35] Këto zhvillime dëshmojnë për qëndrueshmëri të presioneve inflacioniste, të cilat gjithësesi vijojnë të mbeten ende të ulëta në terma historikë.

Inflacioni total i tremujorit në analizë, u ndikua nga vlerat mjaft të ulëta të përbërësve afatshkurtër të tij, veçanërisht atyre të regjistruara në muajin dhjetor. Inflacioni vjetor jobazë dhe ai i tregtueshëm rezultuan përkatësisht 3.2% dhe 0.9%[36], duke reflektuar kryesisht rritjen e pakët dhe krejtësisht të devijuara nga sezoni, të çmimeve të ushqimeve të papërpunuara.

[35] *Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2014, rritjet e inflacionit vjetor në shërbimet e edukimit dhe të komunikimit, kontribuuan me përkatësisht rreth +0.5 p.p. dhe +0.3 pp.. në formimin e inflacionit të patregtueshëm neto.*

[36] *Për muajin dhjetor të vitit 2014, inflacioni jobazë dhe ai i tregtueshëm, rezultuan përkatësisht rreth 1.2% dhe 0.2%, ndër më të ulëtit në historinë e dhjetorëve të dekadës së fundit. Inflacionit të tregtueshëm i është hequr kontributi i efektit të agreguar të paketës fiskale, i cili rezulton thuajse zero në këtë muaj (ndryshimet në akciza për duhanin, taksa e qarkullimit, heqja e TVSh-së së barnave).*

Grafik 25. Prirjet afatgjata të inflacionit (majtas) dhe prirjet afatshkurtra (djathtas)



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të Bankës së Shqipërisë.

3.4 ÇMIMET E HUAJA DHE INFLACIONI I IMPORTUAR

Presionet inflacioniste të gjeneruara nga çmimet e mallrave të konsumit të partnerëve tanë tregtarë kanë ardhur në rënie përgjatë tremujorit të fundit. Indeksi i "*Çmimeve të huaja*"[37] për periudhën në studim, u zgjerua mesatarisht me 3.4% në terma vjetorë, nga 4.3% që shënonte në tremujorin paraardhës. Në prezencën e presioneve disinflacioniste në Evropë, inflacioni i importuar u gjenerua kryesisht nga vende si Turqia dhe Rusia, prej të cilave është regjistruar dhe zgjerim i vëllimit të importuar. Në ndryshim nga tremujori i tretë, leku është nënçmuar lehtë në terma nominalë efektivë në muajt nëntor-dhjetor (përkatësisht 0.4% dhe 1.1%), duke rritur rolin e tij në formimin e TPHI-së (Tregues i Presioneve të Huaja Inflacioniste)[38]. Në reflektim të këtyre dy komponentëve, indeksi TPHI shfaqi një rritje vjetore prej 3.6%, lehtësisht më të ulët se ajo e tremujorit të tretë.

[37] *Është një tregues përafrues mbi presionet e huaja inflacioniste, i krahasueshëm me inflacionin e sektorit të tregtueshëm të mallrave të shportës së IÇK-së sonë. Indeksi i çmimeve të huaja bazohet në vlerat: e inflacionit të kategorisë "Ushqim, pije, duhan" për 18 shtete kryesore; e inflacionit të "Mallrave" (pra, jo vetëm Ushqime) për Bullgarinë, Gjermaninë, Greqinë, Italinë dhe Turqinë. Disa nga mallrat kanë shënuar rritje vjetore të çmimeve, ndërsa janë rritur edhe peshat e importeve me shtetet përkatëse. Kjo ka bërë që vlera përfundimtare e treguesit (mesatare e ponderuar e IÇK-ve të lartpërmendura me peshat mujore të importit të tyre) të shënojë rritje.*

[38] *TPHI-ja llogaritet si rritje vjetore e indeksit të çmimeve të huaja dhe indeksit NEER për muajin përkatës. Presionet inflacioniste me origjinë të huaj vlerësohet që ndikojnë inflacionin me 1-3 muaj vonesë. Gjithsesi, ky tregues mbetet i ndikuar nga masat fiskale të ndërmarra në shtetet e huaja, të cilat jo detyrimisht prekin çmimet e importeve vendase.*

Grafik 26. TPHI-ja dhe kontributet e përbërësve të saj (majtas) dhe kontributi i inflacionit të importuar dhe të brendshëm në atë total vjetor (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rënia e presioneve të huaja inflacioniste ishte dhe arsyeja kryesore e reduktimit të inflacionit total gjatë tremujorit të katërt. Inflacioni i importuar dha një kontribut negativ prej –0.1 pikë përqindjeje në inflacionin total, ndërkohë që inflacioni i gjeneruar në vend shfaqi një qëndrueshmëri relative të kontributit të tij, në nivelin 1.34 pikë përqindjeje. Reduktimi gradual në muajt tetor-nëntor i kontributit pozitiv të inflacionit të importuar, u pasua nga situata e muajit dhjetor 2014, ku ekonomia e vendit vlerësohet të ketë importuar deflacion në masën -0.6 pikë përqindje në inflacionin total. Ndërkohë që kontributi i inflacionit të brendshëm, ndonëse i ulët në terma historikë, mbeti pozitiv dhe i qëndrueshëm rreth vlerës 1.3 pikë përqindje.

Pritjet për inflacionin[39]

Pritjet afatshkurtra të bizneseve, të konsumatorëve dhe të agjentëve financiarë për inflacionin në tremujorin e katërt, mbeten nën objektivin 3% të Bankës së Shqipërisë. Pritjet afatshkurtra të agjentëve financiarë për inflacionin ranë me 0.2 pikë përqindje, duke shënuar vlerën 1.9% në tremujorin e katërt. Edhe pritjet afatmesme të agjentëve financiarë (për inflacionin pas dy vitesh) ranë me 0.1 pikë përqindje, duke regjistruar nivelin 2.2%. Në të kundërt, dinamika tremujore e pritjeve të konsumatorëve ishte rritëse. Pritjet e tyre u rritën me 0.2 pikë përqindje në tremujorin e katërt, por duke mbetur përsëri poshtë mesatares së tyre historike. Pritjet e bizneseve kanë mbetur pothuaj të pandryshuara gjatë dy tremujorëve të fundit, por në vlerë janë më të ulëta, krahasuar me agjentët e tjerë të ekonomisë.

[39] *Analiza mbi pritjet inflacioniste bazohet në rezutatet e vrojtimit të besimit të bizneseve dhe të konsumatorëve, me frekuencë tremujore, si dhe në vrojtimin e pritjeve të agjentëve financiarë, me frekuencë mujore.*

Grafik 27. Pritjet e inflacionit nga agjentë të ndryshëm dhe treguesi i masës së ankorimit



Burimi: Vrojtimet e Besimit dhe Vrojtimi i Agjentëve Financiarë, Banka e Shqipërisë.

4. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE

Kushtet monetare dhe financiare rezultojnë të lehtësuara në tremujorin e katërt. Presionet për likuiditet kanë qenë të përmbajtura dhe treguesit e likuiditetit të sistemit bankar janë përmirësuar. Normat e interesit të huamarrjes për sektorin privat kanë vijuar prirjen rënëse edhe në tremujorin e katërt, por ato ende nuk reflektohen në rritje të qëndrueshme të kërkesës për kredi nga sektori privat. Në të kundërt, kërkesa e sektorit publik për financim ka njohur rritje në tremujorin e katërt. Në prani edhe të pjesëmarrjes më të ulët të bankave në ankandet e letrave me vlerë të qeverisë, kjo ka çuar në rritje të yield-eve gjatë kësaj periudhe. Në tërësi, rritja e masës monetare në ekonomi sugjeron presione të ulëta inflacioniste.

4.1 ZHVILLIMET NË TREGJET FINANCIARE

Normat e interesit në tregun ndërbankar janë karakterizuar nga ecuri rënëse në tremujorin e fundit. Presionet për likuiditet kanë qenë të përmbajtura, ndërkohë që kahu akomodues i politikës monetare ka favorizuar rënien e normave të interesit në këtë tremujor, ashtu si gjatë gjithë vitit. Ulja e normës bazë nga Banka e Shqipërisë në fundin e muajit nëntor, u reflektua menjëherë te interesat e transaksioneve ndërbankare në muajin dhjetor. Normat ditore të interesit në tregun e parasë janë luhatur afër dhe shpesh herë poshtë normës bazë. Interesat njëditore kanë qenë më të qëndrueshme gjatë këtij tremujori[40], ndërsa diferenca e tyre me normën bazë nuk ka ndryshuar nga tremujori i kaluar[41]. Banka e Shqipërisë ka vijuar të kryejë operacionet e rregullta për injektimin e likuiditetit në sistemin bankar. Instrumenti kryesor i përdorur (marrëveshje e anasjellë riblerje repo me afat 7-ditor) është shoqëruar edhe me atë me maturim 1- dhe 3-mujor. Likuiditeti i injektuar në sistem ka qenë lehtësisht më i madh se ai i periudhave paraardhëse, ndërkohë që norma e interesit e rezultuar në këto ankande ka qenë vazhdimisht afër normës bazë.

Mesatarisht, norma mesatare e interesave njëditore në tremujorin e katë rezultoi 2.38%, ose 0.09 pp më poshtë nga ajo e tremujorit të mëparshëm, ndërsa ajo shtatëditore zbriti në 2.40%, nga 2.52% që ishte tre muaj më parë. Bankat kanë rritur volumin e transaksioneve ditore me 0.2 miliardë (1.9 miliardë) dhe atyre javore me 0.7 miliardë (6.8 miliardë) nga tremujori i tretë.

---

[40] *Devijimi standard i interesit ditor në tregun ndërbankar ishte 0.174 në tremujorin e fundit, nga 0.080 një tremujor më parë.*

[41] *Diferenca e normës së interesit ditor me normën bazë ishte 6 pb në tremujorin e fundit, e njëjtë me atë në tremujorin e tretë.*

Grafik 28. Operacionet e tregut të hapur të BSH-së (majtas) dhe ecuria e normave të interesit në tregun ndërbankar (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Yield-t e letrave me vlerë të qeverisë në treg primar

Pas një periudhe të gjatë rënieje, ecuria e *yield*-eve në tregun primar këtë tremujor ka ndërruar kah dhe ka shfaqur prirje rritëse. Zgjerimi i *yield*-eve ka prekur si bonot e thesarit, ashtu edhe instrumentet e tjera afatgjata të qeverisë. Duke nisur nga fundi i muajit shtator, *yield*-i i bonos 12-mujore dhe i maturiteteve të tjera më të vogla ka regjistruar rritje, duke influencuar nivelin e pjerrësisë së kurbës së *yield*-eve. Kërkesa e bankave në ankandet e zhvilluara shpesh herë ka qenë më poshtë se shumat e emetuara, duke shtuar kështu presionet rritëse tek *yield*-et. Pas një përqasjeje pozitive dhe pranie aktive në gjysmën e parë të vitit, bankat kanë nguruar të marrin pjesë në ankande në muajt e fundit. Më shumë se situata e likuiditetit dhe rishikimi i pritjeve për situatën e përgjithshme ekonomike, faktorë kryesorë që ka ndikuar këtë sjellje kanë qenë politikat më të shtrënguara të imponuara nga bankat mëma që origjinojnë nga vendet e Bashkimit Evropian. Nga ana tjetër, edhe kërkesa e qeverisë për financim në tremujorin e katërt ka rezultuar më e lartë, duke shtuar presionet te *yield*-et.

Grafik 29. Ecuria e yield-eve në tregun primar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Yield-i 12-mujor ka shënuar nivelin 3.45% në fund të muajit dhjetor, nga 3.22% në fund të shtatorit. Një rritje të fortë ka patur edhe *yield*-i 3-mujor, ndërkohë që ai 6-mujor ka qenë më i qëndrueshëm. Interesi i bonove 3-mujore shënoi mesatarisht 3.12% në tremujorin e fundit, nga 3.02% tre muaj më parë. Në këtë drejtim influencoi edhe përdorimi më i shpeshtë i këtij instrumenti në financimin afatshkurtër nga qeveria, gjatë kësaj periudhe. *Yield*-et e obligacionit 3-, 5- dhe 10-vjeçar me interes fiks përfituan nga rritja e interesimit në ankandet respektive dhe arritën të ruajnë nivelin e muajve të mëparshëm. Nga ana tjetër, obligacionet 2- dhe 7-vjeçare kanë regjistruar rritje muaj pas muaji, duke e mbyllur vitin me respektivisht 5.04% dhe 7.85%, nga 4.89% dhe 7.77% që ishin në fund të tremujorit të tretë. Mungesa e kërkesës ka influencuar më dukshëm *yield*-et e instrumenteve me normë të ndryshueshme[42], në një kohë që, përveç rritjes së *yield*-it 12-mujor të përdorur si indeks, edhe marzhet e kërkuara mbi të janë rritur. Kështu, për obligacionet 5-, 7- dhe 10-vjeçare me *yield* të ndryshueshëm, primet e kërkuara mbi indeksin u rritën me 0.14, 0.03 dhe 0.15 pikë përqindje.

Normat e interesit të depozitave dhe kushtet e financimit[43]

Normat e interesit të depozitave në lekë kanë ndjekur ecuri rënëse në tremujorin e fundit. Në terma mesatarë, interesi i depozitave në lekë shënoi 1.65% këtë tremujor, ose 0.14 pikë përqindje më pak nga tremujori i tretë. Interesi për depozitat 12-mujore në lekë shënoi 1.57% në muajin nëntor, duke u ulur me 0.16 pikë përqindje nga niveli i tremujorit të mëparshëm. Zvogëlimi i normave të interesit të depozitave në lekë është shtrirë tek të gjitha maturitetet kryesore. Normat e depozitave në euro janë shfaqur më të qëndrueshme, duke regjistruar ulje të lehta. Diferenca midis interesit të depozitave me afat në lekë dhe atyre në euro është ngushtuar, si pasojë e rënies më të madhe të të parave. Mesatarisht, interesi për depozitat 12-mujore në euro rezultoi 0.62% në tetor-nëntor, nga 0.65% në tremujorin e tretë të 2014.

Grafik 30. Normat e interesit të kredisë së re në lekë*



*Seria është rregulluar si mesatare rrëshqitëse 6-mujore, me qëllim sheshimin e luhatshmërisë së lartë që e karakterizon atë.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

[42] *Raporti bid/cover i përgjithshëm i këtyre tre muajve për këto instrumente ishte mesatarisht 0.35.*

[43] *Të dhënat më të fundit zyrtare për normat e interesit për kreditë dhe depozitat e reja i përkasin muajit nëntor 2014. Tremujori i katërt është përafruar si mesatare e muajve tetor-nëntor.*

Normat e interesit të aplikuara për **kredinë e re në lekë** kanë vijuar të ulen edhe në muajt tetor–nëntor.[44] Në vrojtimin e aktivitetit kreditues, bankat shprehen se prirja për rënien e normës së interesit të kredisë në lekë do të vijojë edhe në tremujorin e ardhshëm. Marzhet e interesit të kredisë mbi interesat e instrumenteve të tjera në lekë janë ngushtuar, kryesisht si rrjedhojë e uljes së normave të kredisë. Ndryshe nga tremujori i kaluar, normat e interesit të kredisë në lekë janë ulur më tepër për bizneset dhe më pak për individët. Interesi afatgjatë, i cili lidhet kryesisht me kredi investimi, ka rënë mesatarisht në 7.4% në muajt tetor-nëntor, nga 7.9% në tremujorin e tretë. Krahas tij, edhe segmenti afatmesëm ka regjistruar ulje dhe niveli i tij mesatar për dy muajt e fundit rezultoi i zvogëluar me 0.25% nga tremujori i mëparshëm, në 10.31%. Rënia e interesave afatgjata ka qenë e pranishme tek të dyja kategoritë (biznese, individë), duke mbështetur si kredinë hipotekare, ashtu edhe kredinë për investime.

Diferenca midis interesave afatgjata të kredisë së re dhe *yield*-eve të obligacioneve 5-vjeçare është ngushtuar dukshëm këto muaj në 0.82 pikë përqindje, nga 1.27 pikë përqindje në tremujorin e tretë. Diferenca midis interesit të kredisë dhe atij për depozitat në lekë gjithashtu ka rënë në dy muajt e fundit.

Interesat e kredisë në euro janë treguar të luhatshme, ndërkohë që, në terma mesatarë, niveli i tyre mbeti afërsisht i njëjtë me tremujorin e kaluar. Vlen për t'u theksuar ulja e interesave tek segmenti afatgjatë, e cila vijon prej disa muajsh, ndërkohë që segmentet e tjera kanë treguar luhatshmëri dhe rritje. Në analizë përdorimi, interesat për kredi të individëve janë zvogëluar, ndërsa ato për bizneset kanë njohur rritje. Diferenca midis interesit të kredisë dhe atij të depozitave në euro ka vijuar të zgjerohet, si pasojë e reduktimit të shpejtë të këtyre të fundit.

Grafik 31. Normat e interesit të kredisë së re në euro dhe ato për depozita*



Seria e interesave për kredinë e re në euro është rregulluar si mesatare rrëshqitëse 6 mujore, me qëllim sheshimin e luhatshmërisë së lartë që e karakterizon atë.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

[44] *Ecuria e tyre ka qenë e luhatshme, e ndikuar shpesh nga pesha dhe çmimi i aplikuar nga banka të caktuara, por këto lëvizje nuk kanë ndërhyrë në ndryshimin e prirjes rënëse.*

Pavarësisht reduktimit të normave të interesit, kushtet e tjera të kreditimit të aplikuara nga sistemi bankar vazhdojnë të mbeten të shtrënguara. Përmirësimi i lehtë i tyre gjatë vitit 2014 u frenua në tremujorin e katërt.

HAPËSIRË INFORMUESE 3: PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE NGA VROJTIMI I AKTIVITETIT KREDITUES

*Rezultatet e Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues në tremujorin e katërt të vitit 2014, tregojnë për ndryshime të vogla në kahun shtrëngues të **standardeve të kredidhënies** të aplikuara nga bankat për bizneset, dhe për ngadalësim të prirjes lehtësuese për individët.*

Grafik 32. Standardet e kredisë për bizneset dhe per individët (balanca neto)



Burimi: Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues, Banka e Shqipërisë.

Pasi u lehtësuan gjatë pjesës së parë të vitit, standardet e kredisë për biznese u shtrënguan lehtësisht gjatë tremujorit të fundit të vitit, kryesisht si pasojë e shtrëngimit të standardeve të kredisë së dhënë për qëllim të financimit të investimeve. Për kredinë dhënë individëve, bankat shprehen për lehtësim ndjeshëm më të ulët të standardeve, krahasuar me pjesën e parë të vitit. Masa e lehtësimit të standardeve ishte më e ulët, si për kredinë për blerje banese ashtu dhe për kredinë konsumatore.

*Ecuria e standardeve u ndikua pozitivisht nga **faktorë** që lidhen me gjendjen e likuiditetit të vetë bankave, nivelin e konkurrencës në sistemin bankar dhe politikat e ndjekura nga Banka e Shqipërisë. Disa nga faktorët kryesorë që dhanë ndikim për shtrëngimin e standardeve janë gjendja financiare e individëve dhe e bizneseve, kreditë me probleme, si dhe problemet specifike të sektorit ku operon biznesi.*

***Kushtet** kryesore me të cilat bankat zbatuan një politikë shtrënguese për bizneset ishin zgjerimi i marzhit për kreditë me rrezik dhe ulja e madhësisë së kredisë. Për individët, kushtet kryesore të përdorura nga bankat në zbatimin e politikës lehtësuese të standardeve ishin rritja e maturitetit dhe e madhësisë së kredisë.*

***Kërkesa** për kredi gjatë tremujorit të katërt të vitit 2014 është vlerësuar e rritur, si për bizneset ashtu dhe për individët. Për individët, përqindja neto e bankave që shprehen për rritje të kërkesës është në rënie në krahasim me tremujorin e kaluar.*

***Pritjet** e bankave për tremujorin e parë të vitit 2015 nuk ndryshojnë shumë nga vlerësimi i tyre për situatën e tremujorit të katërt 2014. Standardet e kredidhënies pritet të përmirësohen lehtësisht, si për bizneset ashtu dhe për individët. Nga ana tjetër, kërkesa pritet të vijojë të jetë e ngadaltë.*

Grafik 33. Kërkesa për kredi për bizneset dhe individët (balanca neto)



Burimi: Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues, Banka e Shqipërisë.

Kursi i këmbimit

Ecuria e lekut është karakterizuar nga vlera të lehta nënçmimi në tremujorin e fundit të vitit 2014. Indeksi NEER[45], shënoi një rritje vjetore mesatare për periudhën në analizë me 0.3%, nga tkurrja me 1.8% që shënonte në periudhën janar-tetor 2014. Pavarësisht dobësimit të euros ndaj monedhës vendase, nënçmimi i ndjeshëm i kësaj të fundit ndaj dollarit amerikan duket të ketë mbajtur indeksin në nivele jo shumë të ndryshme nga ato të tremujorit të katërt 2013. Në terma realë, monedha vendase vazhdoi të shfaqë vlera mbiçmuese (0.3%), si rrjedhojë e rënies më të shpejtë të inflacionit në vendet partnere tregtare të Eurozonës në krahasim me atë në vend. Në linjë me zhvillimet e mësipërme, indeksi i presioneve në tregun valutor nuk paraqet presione të shtuara mbi monedhën vendase.

Grafik 34. Ndryshimet vjetore të indeksit NEER,
indeksi i presioneve në tregun valutor dhe kursi bilateral i këmbimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[45] *NEER – kursi nominal efektiv i këmbimit llogaritet kundrejt monedhave të pesë partnerëve tregtarë kryesorë, të cilët janë Italia, Greqia, Gjermania, Turqia dhe Kina. Një rritje e NEER-it do të thotë nënçmimi i lekut.*

Në tremujorin e fundit, një euro u këmbye mesatarisht me 139.74 lekë, ose 0.5% më lirë se një vit më parë. Ndonëse në këtë periudhë deficiti tregtar rezultoi në zgjerim, prurjet më të larta valutore në terma vjetorë, të sinjalizuara nga depozitat, si dhe nënçmimi i euros në tregjet ndërkombëtare, duket të kenë dobësuar pozitat e tij edhe në tregun vendas. Dinamikat brenda tremujorit tregojnë për një forcim më të dukshëm të monedhës evropiane ndaj lekut, veçanërisht gjatë muajit dhjetor (me 0.5% ndaj vlerës mesatare të muajit tetor), të diktuar kryesisht nga një rritje e kërkesës për valutë nga ana e agjentëve ekonomikë. Ky zhvillim u reflektua edhe në efektin e munguar sezonal karakteristik të fundvitit[46].

Dollari amerikan vazhdoi të fitojë terren ndaj lekut, si në terma vjetorë (8.4%) ashtu edhe në ato tremujorë (6.1%), duke reflektuar trajektoren e kursit euro/dollar në tregje ndërkombëtare në tremujorin e katërt. Në këtë periudhë, vlera mesatare e një dollari amerikan ishte përafërsisht 114 lekë, ndër më lartat në dy vitet e fundit.

4.2 ECURIA E KREDITIMIT[47]

Kredia për ekonominë ka vijuar të rritet në muajt tetor dhe nëntor. Rritja vjetore e saj rezultoi 3.8% në fund të muajit nëntor, nga 1.6% që shënonte në fund të tremujorit të tretë të vitit. Zhvillim pozitiv dhe i qëndrueshëm është rritja e dukshme e kreditimit në lekë, kundrejt një ecurie të dobët të atij në valutë, duke ndihmuar kështu një përcjellje më të mirë të stimulit monetar në ekonomi. Kredia në lekë u rrit me 9.3% në terma vjetorë në muajin nëntor, ndërkohë që kredia në valutë është tkurrur me 0.9% kundrejt vitit të kaluar[48]. Përmirësimi i dinamikës vjetore ka rezultuar kryesisht si rrjedhojë e shuarjes së efektit statistikor të ardhur prej reduktimit të pazakontë të kredisë në muajin tetor të vitit 2013. Zhvillimet mujore në kredi kanë qenë më të dobëta krahasuar me tremujorin e tretë të vitit, momenti pozitiv i të cilit nuk zgjati përtej muajit gusht[49].

Përtej luhatjeve mujore dhe efekteve statistikore, kreditimi i ekonomisë, veçanërisht ai për sektorin privat, mbetet në nivele të ulëta. Raporti i kredisë ndaj PBB-së[50] vlerësohet në 37.4% në fund të tremujorit të tretë të vitit 2014, ose rreth 0.6 pikë përqindje më i ulët se një vit më parë. Kredia për sektorin privat rritet në mënyrë të segmentuar dhe rimëkëmbja e qëndrueshme e saj vijon të pengohet nga kundërshtia e lartë ndaj rrezikut e agjentëve ekonomikë. Bankat vazhdojnë të jenë të kujdesshme në kredidhënie, veçanërisht në financimin e bizneseve. Nga ana tjetër, edhe kërkesa për kredi është më e përqendruar në segmentin afatshkurtër.

---

[46] *Në fund të muajit dhjetor, raporti euro/lekë nuk zbriti më poshtë se kuota 139.87 lekë.*

[47] *Për një analizë të detajuar për aktivitetin kreditues, shiko materialin: "Tendencat në kreditim-tremujori i katërt 2014", në www.bankofalbania.org.*

[48] *Pastruar nga efekti i kursit të këmbimit.*

[49] *Efekti i kursit të këmbimit në zhvillimet mujore të kredisë ishte veçanërisht i fortë në muajin nëntor. Në total, gjatë muajve tetor dhe nëntor, kredia është rritur me rreth 5 miliardë lekë. Pastruar nga luhatjet e kursit të këmbimit, kjo rritje rezulton 4 miliardë lekë, thuajse e gjitha në monedhë vendase.*

[50] *PBB-ja nominale është vlerësim i stafit të bankës.*

Grafik 35. Kredia për ekonominë kundrejt vlerës së shtuar dhe PBB-së nominale



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kredia për biznese ka qenë nxitësi kryesor i rritjes së kredisë për sektorin privat. Ajo ka regjistruar fluks pozitiv në këta dy muaj, kryesisht në formën e financimit afatshkurtër. Në fund të muajit nëntor, rritja vjetore e saj ishte 5.1%, ose 2.4 pikë përqindje më e lartë se në fund të tremujorit të tretë të vitit. Përmirësimi i kredisë për biznese është më i pranishëm në kredinë për likuiditet dhe më pak në atë për investime. Rritjet vjetore të këtyre dy portofoleve shënuan përkatësisht 5.9% dhe 3.6%, në fund të muajit nëntor. Gjatë këtyre dy muajve, bankat kanë financuar kryesisht sektorin e industrisë, në të gjitha degët e tij, dhe atë të ndërtimit.

Grafik 36. Kredia për biznese sipas monedhës (majtas) dhe qëllimit të përdorimit (djathtas)



Shënim: Kontributi i kredisë në valutë është zhveshur nga efekti i kursit të këmbimit.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Financimi në lekë i bizneseve private është rritur në mënyrë të qëndrueshme gjatë vitit 2014. Rritja vjetore e tij ka arritur në 12.0% në muajin nëntor, nga 0.9% që shënonte në fund të vitit 2013. Ecuria e mirë e kreditimit në lekë të bizneseve në muajt tetor dhe nëntor është vërejtur si në financimin afatshkurtër,

ashtu edhe në atë afatgjatë. Kreditimi i bizneseve në valutë, pas tkurrjes prej gati dy vjetësh, ka dhënë një kontribut të vogël në rritjen e kredisë për biznese, në katër muajt e fundit. Si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve, pesha e kredisë në lekë për bizneset qëndron në 34.9% në fund të muajit nëntor, me një rritje prej 1.2 pikë përqindjeje[51] kundrejt fundit të vitit 2013.

Kredia për individë ka vijuar të shfaqet e plogësht edhe në muajt tetor dhe nëntor. Në këta dy muaj, fluks pozitiv ka regjistruar vetëm kredia konsumatore, ndërkohë që ajo për pasuri të patundshme është tkurrur. Rritja vjetore e kredisë për individë shënoi 0.9% në fund të muajit nëntor, nga 0.4% që shënonte në fund të tremujorit të tretë të vitit. Kredia hipotekare është tkurrur në terma vjetorë, me një normë mesatare prej -0.5% në të dy muajt. Ndërkohë, rritja vjetore e kredisë konsumatore është përmirësuar më tej, në 6.2% në muajin nëntor, si rrjedhojë e ecurisë pozitive të këtij portofoli edhe gjatë këtyre muajve.

Grafik 37. Kredia për individë sipas monedhës (majtas) dhe qëllimit të përdorimit (djathtas)



Shënim: Kontributi i kredisë në valutë është zhveshur nga efekti i kursit të këmbimit.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në financimin e individëve është edhe më e dukshme ecuria e kundërt mes kredisë në lekë dhe asaj në valutë. Në katër muajt e fundit, kredia në lekë është rritur me një normë mesatare vjetore prej 6.1%, duke dhënë një kontribut të shtuar në rritjen e kredisë për individë në krahasim me muajt e tjerë të vitit 2014. Ajo është përshpejtuar nga rritja e kredisë konsumatore, por edhe kredia hipotekare në lekë ruan një kontribut të qëndrueshëm në rritjen e saj. Nga ana tjetër, kredia në valutë, e zhveshur nga efekti i kursit të këmbimit, duke vijuar të tkurret dhe në muajin nëntor, është 3.9% më e ulët se një vit më parë. Ndërgjegjësimi më i madh i individëve për kredimarrjen në valutë, së bashku me ngushtimin e diferencës mes normave të interesit kreditor në lekë dhe në valutë, kanë orientuar ndjeshëm kërkesën e individëve për kredi drejt monedhës vendase. Pesha e kredisë për individët në lekë qëndron në 50.6% në fund të muajit nëntor, ose 2.4 pikë përqindje[52] më shumë se në fund të vitit 2013.

[51] Kjo shifër është e pastruar nga efekti i kursit të këmbimit.
[52] Kjo shifër është e pastruar nga efekti i kursit të këmbimit.

HAPËSIRË INFORMUESE 4: REZULTATET E VROJTIMIT TË AKTIVITETIT KREDITUES NË VENDET E EVROPËS QENDRORE DHE JUGLINDORE (EQJL), GJASHTËMUJORI I DYTË 2014

Në kuadër të Iniciativës së Vjenës, Banka Evropiane e Investimit (BEI) kryen dy herë në vit një vrojtim të aktivitetit kreditues në vendet e EQJL-së. Në dallim nga vrojtime të ngjashme që kryhen në shumicën prej këtyre vendeve, vrojtimi i kryer nga BEI përfshin edhe një seksion mbi opinionin e bankave mëma evropiane mbi investimet e tyre në vendet e EQJL, përqasjen që ato kanë ndaj këtyre investimeve dhe strategjitë për të ardhmen. Vrojtimi më i fundit është realizuar në muajin shtator dhe mbulon gjysmën e dytë të vitit 2014. Në vijim po paraqesim konkluzionet kryesore të këtij vrojtimi mbi opinionet e bankave mëma, për rajonin dhe për Shqipërinë. Opinionet e filialeve të tyre në Shqipëri janë përgjithësisht në linjë me rezultatet e marra nga Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues i kryer nga Banka e Shqipërisë dhe për këtë arsye, nuk janë përfshirë në këtë hapësirë informative.

Bankat ndërkombëtare aktive në rajonin e EQJL-së konfirmojnë vazhdimësinë e procesit të ristrukturimit dhe të reduktimit të investimeve të tyre në nivel grupi, kryesisht nëpërmjet shitjes së degëve dhe aktiveve të tjera të tyre. Ato mbeten përgjithësisht të angazhuara në investimin e tyre në rajon, por strategjitë e tyre janë qartësisht të ndryshme për vende të ndryshme. Deri tani, gjysma e bankave të intervistuara kanë reduktuar ekspozimin e tyre në rajonin e EQJL-së. Në të ardhmen, një e treta e tyre presin të rrisin ekspozimin e tyre në këto vende dhe po aq mund të reduktojnë më tej operacionet në to. Përfitueshmëria e filialeve në vendet e rajonit po kthehet në një sfidë - kthimi i pritur ndaj aktiveve në vendet e EQJL-së po ulet në krahasim me rezultatet në nivel grupi. Bankat janë ende në proces vlerësimi të potencialit individual të tregjeve të rajonit. Në fund të këtij vlerësimi, mund të ketë edhe rishpërndarje gjeografike të fokusit të këtyre bankave në rajon, në afat të mesëm.

Rezultatet e këtij vrojtimi sugjerojnë se rikuperimi i ngadaltë i kredisë i atribuohet si faktorëve të kërkesës, ashtu edhe atyre të ofertës. Bankat besojnë se kërkesa do të rikuperohet më shpejt se oferta në vendet e EQJL-së. Burimet e financimit dhe likuiditeti nuk përbëjnë më shqetësim për aktivitetin kreditues, duke qenë se filialet e kanë zëvendësuar financimin e bankave mëma me depozita vendase. Cilësia e kredisë, në nivel grupi dhe lokal, së bashku me kuadrin rregullator, përbëjnë pengesën më të madhe në rritjen e kreditimit.

Në rastin e Shqipërisë, janë intervistuar pesë banka evropiane, filialet shqiptare të të cilave zotërojnë 54% të aktiveve totale të sistemit bankar në Shqipëri. Gjykimi i tyre për ekonominë shqiptare evidenton rrezikun për rimëkëmbjen ekonomike, ndërkohë që shqetësimi kryesor mbetet niveli i lartë i kredive me probleme.

Katër nga pesë grupet e intervistuara bankare prezente në Shqipëri kanë vijuar me shitjen e aktiveve në nivel grupi. Ky proces është ngadalësuar, por rreth një e treta e tyre pranojnë se do të vazhdojnë të reduktojnë raportin kredi/depozita në nivel grupi. Bankat mëma vazhdojnë ta shohin Shqipërinë si një treg me potencial të ulët/mesatar dhe shumica e tyre nuk janë të kënaqura me pozicionimin e tyre në treg.

Grupet bankare që operojnë në Shqipëri janë përgjithësisht më përzgjedhëse në strategjitë e tyre lokale. Kthimi ndaj kapitalit dhe ai ndaj aktiveve në Shqipëri raportohen më të ulët se mesataret e rajonit. Megjithatë, ka shenja për përmirësime të mundshme në afat më të gjatë. Kthimi ndaj aktiveve është më i lartë se mesatarja e grupit për disa nga bankat, ndërkohë që disa prej tyre po tregojnë gatishmëri për të zgjeruar aktivitetin në Shqipëri. Pavarësisht se të paktën dy prej grupeve bankare të intervistuara raportojnë se synojnë të reduktojnë operacionet e tyre në Shqipëri, ky numër është më i ulët se në vrojtimin e kryer në muajin mars të këtij viti.

Grafik 38. Tregues të ndryshëm mbi ekspozimet e grupeve bankare në rajon



*Kthimi nga aktivet, i korrigjuar për koston e rrezikut, krahasuar me këtë tregues në nivel grupi; kthimi nga kapitali, i korrigjuar për koston e kapitalit, krahasuar me këtë tregues në nivel grupi.

Burimi: Banka Evropiane e Investimit, Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues për EQJL, gjysma e dytë e vitit 2014.

Në grafikun më sipërm paraqiten përgjigjet e grupeve bankare për të gjithë rajonin. Nga ky vështrim krahasues, vihet re një ndarje e rajonit në dy grupe. Grupi i parë, i përbërë nga vende kryesisht të Evropës Qendrore dhe përgjithësisht më të zhvilluara nga pjesa tjetër e rajonit (Republika Çeke, Polonia, Bullgaria dhe në disa raste, Rumania) vlerësohen më mirë në krahasim me vendet e tjera të EQJL-së. Përjashtim nga ky grup bën Hungaria, performanca e dobët e së cilës ndikohet ndjeshëm nga kushtet më të përkeqësuara ekonomike të saj. Shqipëria bën pjesë në grupin e dytë të vendeve, kryesisht ato juglindore, së bashku me Serbinë, Kroacinë dhe Bosnje-Hercegovinën. Ky grup vendesh, në tërësi, konsiderohet nga bankat evropiane me potencial më të dobët të tregut dhe me përfitueshmëri më të ulët. Kjo vërejtje sinjalizon mundësinë e një faktori strukturor/gjeografik në vlerësimet e bankave evropiane për operacionet e tyre në vendet e rajonit. Brenda këtij rajoni më të ngushtë, Shqipëria renditet krahasimisht më mirë në terma të potencialit të tregut dhe të pozicionimit në treg. Ndërkohë, sipas këtij vrojtimi, treguesit e përfitueshmërisë e vendosin atë në pozita jo konkurruese, në krahasim me vendet e tjera fqinje.

4.3 ECURIA E TREGUESVE MONETARË

Pas ngadalësimit të vërejtur në tremujorin e tretë të vitit, **paraja e gjerë** regjistroi një rritje mesatare vjetore prej 1.6% në muajt tetor dhe nëntor. Ky përmirësim ka reflektuar rritjen e kredisë për sektorin privat, ndërkohë që kontributi i financimit të sektorit publik ka mbetur negativ dhe thuajse në të njëjtat nivele si në dy muajt e mëparshëm. Komponenti valutor vazhdon të japë kontributin më të lartë në rritjen e M3. Agregati M2 regjistroi ndryshime pozitive vjetore në këta dy muaj, në reflektim të rritjes së qëndrueshme të kredisë në lekë. Reduktimi i normave të interesit për depozitat ka çuar në zhvendosjen e parasë në komponentët më likuidë të saj. Rritja vjetore e agregatit M1 shënoi 11.7% në fund të muaji nëntor, ose rreth 2.7 pikë përqindje më shumë se në fund të tremujorit të tretë të vitit. Edhe paraja jashtë bankave është rritur në terma mujorë e vjetorë, duke ruajtur një raport të lartë të saj ndaj M2, prej 29.5%.

Grafik 39. Zhvillimet në agregatët monetarë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në përgjithësi, ecuria e agregatëve monetarë është diktuar nga rritja e ekonomisë nën potencial dhe nga kërkesa e ulët e agjentëve ekonomikë për financim bankar. Në të njëjtën kohë, zhvillimet në para vazhdojnë të ndikohen edhe nga zhvendosja strukturore e mjeteve monetare në mjete financiare jashtë përkufizimit të parasë së gjerë. Këto të fundit përfaqësohen kryesisht nga depozitat me afat mbi dy vjet dhe nga investimet e individëve në letra me vlerë të qeverisë[53].

Depozitat e përfshira në paranë e gjerë[54] shënuan një rritje mesatare vjetore prej 1.0% në muajt tetor dhe nëntor, duke frenuar ngadalësimin e mëtejshëm të tyre. Në këta dy muaj, depozitat në lekë u rritën me rreth 5.0 miliardë lekë, të ndikuara nga rritja e depozitave kryesisht pa afat të bizneseve private dhe atyre publike. Depozitat në valutë u tkurrën me 5.5 miliardë lekë[55], në reflektim të rënies së depozitave me afat të bizneseve private dhe të individëve. Depozitat në lekë vijojnë të tkurren kundrejt një viti më parë, por me një normë më të ulët, prej rreth 0.6% në muajin nëntor. Ndërkohë, depozitat në valutë janë ngadalësuar më tej, duke regjistruar një rritje vjetore prej 2.4% në muajin nëntor[56].

Në zhvillimet në depozita vijon të jetë e pranishme zhvendosja nga depozita me afat në depozita pa afat, si në monedhën vendase ashtu edhe në atë në valutë. Paralelisht me të, ecuria e depozitave në këta dy muaj është prekur edhe nga rritja e depozita me afat mbi dy vjet, veçanërisht në monedhën vendase. Depozitat me afat mbi dy vjet janë rritur me rreth 13.3 miliardë lekë që nga fillimi i vitit 2014, duke e çuar peshën e tyre ndaj depozitave totale me afat në 7.0%, ose 2.0 pikë përqindje më shumë se në fund të vitit 2013.

[53] *Në muajin nëntor raporti i këtyre investimeve ndaj totalit të investimeve të individëve ishte 16.1%, përkundrejt 14% që shënonte në fund të vitit 2013.*

[54] *Këtu përfshihen depozitat pa afat dhe depozitat me afat nën dy vjet.*

[55] *Duke përjashtuar efektin e kursit të këmbimit, tkurrja mujore e depozitave në valutë ishte 7.0 miliardë lekë.*

[56] *Pastruar nga efekti i kursit të këmbimit, rritja vjetore e depozitave në valutë rezulton 1.2%, duke shfaqur një ngadalësim më të fortë.*

Grafik 40. Zhvillimet në depozitat e përfshira në M3 (majtas) dhe në depozitat totale (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

SHTOJCA STATISTIKORE | STATISTICAL APPENDIX

TREGUES TË PËRGJITHSHËM MAKROEKONOMIKË	56	MAIN MACROECONOMIC INDICATORS
1. Zhvillimet monetare dhe normat e interesit	56	Monetary developments and interest rates 1.
2. Prodhimi i brendshëm bruto, indekset e çmimeve dhe tregu i punës	56	Gross domestic product, price indexes and labor market 2.
3. Bilanci i pagesave, rezerva dhe kursi i këmbimit	57	Balance of payments, reserves and exchange rate 3.
4. Bilanci fiskal, stoku i borxhit të brendshëm dhe borxhi i jashtëm	57	Fiscal balance, domestic debt stock and external debt 4.
1 SEKTORI FINANCIAR	58	FINANCIAL SECTOR 1
1-1 Bilanci sektorial i Bankës së Shqipërisë	58	Sectoral balance sheet of Bank of Albania 1-1
1-2 Paraqitja monetare e Bankës së Shqipërisë	59	Monetary survey of Bank of Albania 1-2
1-3.a Bilanci sektorial i bankave paradepozituese/ Mjetet	60	Sectoral balance sheet of money deposit banks/ Assets 1-3.a
1-3.b Bilanci sektorial i bankave paradepozituese/ Detyrimet	61	Sectoral balance sheet of money deposit banks/ Liabilities 1-3.b
1-4 Paraqitja monetare e bankave paradepozituese	62	Monetary survey of deposit money banks 1-4
1-5 Bilanci sektorial i shoqërive të kursim-kreditit	63	Sectoral balance sheet of savings and loan associations 1-5
1-6 Paraqitja monetare e korporatave të tjera depozituese	64	Monetary survey of other depository corporations 1-6
1-7 Paraqitja monetare e korporatave depozituese	65	Monetary survey of depository corporations 1-7
1-8.a Agregatët monetarë dhe përbërësit e tyre	66	Monetary aggregates and their components 1-8.a
1-8.b Kundërpartitë e agregatëve monetarë	66	Counterparts of monetary aggregates 1-8.b
1-9 Depozitat në lekë sipas sektorëve	67	Lek denominated deposits by sector 1-9
1-10 Depozitat në valutë sipas sektorëve	67	Foreign currency denominated deposits by sector 1-10
1-11 Kredia për ekonominë sipas sektorit	68	Credit to economy by sector 1-11
1-12 Kredia sipas aktivitetit ekonomik	68	Loans by economic activity1 1-12
1-13 Kredia për bizneset sipas qëllimit të përdorimit dhe monedhës	69	Business loans by purpose and currency 1-13
1-14 Kredia për individët sipas qëllimit të përdorimit dhe monedhës	70	Household loans by purpose and currency1 1-14
1-15 Kredia sipas rretheve	71	Loans by districts 1-15
1-16 Normat e interesit të Bankës së Shqipërisë	71	Bank of Albania interest rates 1-16
1-17 Normat e interesit për depozitat e reja sipas monedhës	72	Interest rates on new deposits by currency 1-17
1-18 Normat e interesit për kreditë e reja sipas monedhës	72	Interest rates on new loans by currency 1-18
1-19 Normat e interesit për bonot e thesarit sipas afatit	73	Maturity breakdown of Treausury bill yields 1-19
1-20 Sistemi i pagesave ndërbankare	74	Interbank payment system 1-20
1-21 Shpërndarja rajonale e terminaleve të ATM dhe POS	74	Number of ATM & POS terminals by region 1-21
1-22 Numri i llogarive të klientëve në banka	74	Number of customer accounts with banks 1-22
2 SEKTORI I JASHTËM	75	EXTERNAL SECTOR 2
2-1A Bilanci i Pagesave	75	Balance of payments 2-1A
2-1B Bilanci i Pagesave	75	Balance of payments 2-1B
2-2 Kursi i këmbimit të lekut kundrejt monedhave kryesore	76	Exchange rate 2-2
2-3 Eksporti sipas grup mallrave	76	Export by commodity groups 2-3
2-4 Importi sipas grup mallrave	77	Import by commodity groups 2-4
2-5 Borxhi i jashtëm bruto	77	Gross external debt 2-5
3 SEKTORI FISKAL	78	FISCAL SECTOR 3
3-1 Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar	78	Fiscal indicators regarding consolidated budget 3-1
3-2 Stoku i borxhit të brendshëm sipas instrumenteve	78	Domestic debt stock by instruments 3-2
4 SEKTORI REAL	79	Real Sector 4
4-1 Prodhimi i brendshëm bruto sipas aktivitetit ekonomik	79	Gross domestic product by economic activities 4-1
4-2 Indeksi i çmimeve të prodhimit dhe indeksi i kushtimit në ndërtim (për banesa)	80	Producer price index and construction cost index 4-2 (for dwellings)
Ndryshimet në përqindje të indeksit të çmimeve të prodhimit dhe të indeksit të kushtimit në ndërtim	80	Change in % of producer price index and construction cost index
4-3 Indeksi i çmimeve të konsumit	81	Consumer price index 4-3
4-4 Punësimi, papunësia dhe pagat	82	Employment, unemployment and wages 4-4

1. ZHVILLIMET MONETARE DHE NORMAT E INTERESIT
MONETARY DEVELOPMENTS AND INTEREST RATES 1.

NË MILIARDË LEKË, PËRVEÇ RASTEVE KUR SHËNOHET NDRYSHE, FUND PERIUDHE

IN BILLIONS ALL, UNLESS OTHERWISE INDICATED, END OF PERIOD

	Agregatët monetarë/ Monetaryaggregates			Depozitat[1]/ Deposits[1]	Kredia[2] / Credit[2]	Normat e interesit 12m / 12m interest rates (%)			Norma e marrëveshjes së riblerjejes njëjavore [4] Weekly repurchase agreement rate[4]
	M1	M2	M3			Depozita[3] / Deposits[3]	Kred[3]/ Loans[3]	Bono Thesari/ T. Bills	
	1	2	3	4	5	6	7	8	9
2009	284.5	578.2	871.5	662.4	440.4	6.78	12.46	9.14	5.25
2010	275.4	604.5	980.3	785.2	483.1	6.40	11.29	7.09	5.00
2011	276.9	647.0	1,070.1	875.2	541.9	5.87	11.17	6.95	4.75
2012	281.2	669.6	1,123.4	930.7	554.7	5.38	10.28	6.37	4.00
2013	295.9	693.2	1,149.0	950.1	547.9	4.17	9.52	3.66	3.00

Burimi: Banka e Shqipërisë

Source: Bank of Albania

2. PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO[5], INDEKSET E ÇMIMEVE DHE TREGU I PUNËS
GROSS DOMESTIC PRODUCT[5], PRICE INDEXES AND LABOR MARKET 2

	Rritja reale vjetore e PBB me çmime konstante (%)/ Annual real growth of GDP at constant prices (%)	Me çmime korrente, në milionë lekë/ At current prices, in million ALL				Ndryshimet vjetore të Indekseve (%) / Yearly Index change (%)	Indekset Mesatare Vjetore të çmimeve të Prodhimit (NVE Rev.2 2010=100 / Average Annual Indices of Producer Prices (NACE Rev.2) 2010=100	Tregu i punës[7]/ Labor market[7]	
		Produkti Brendshëm Bruto (PBB)/ Gross domestic product (GDP)	Pagat e të punësuarve, neto /Compensation of employees, net	Të Ardhura nga prona, neto/ Property income, net	Të Ardhurat Kombëtare Bruto/ Gross National Income	IÇK[6] / CPI[6]		Shkalla e punësimit/ Employment rate (%)	Shkalla e papunësisë/ Unemployment rate (%)
	1	2	3	4	5=2+3+4	6	7	8	9
2009	3.4	1,143,936.5	20,783.6	-38,969.4	1,125,750.7	3.5	0.4	53.5	13.8
2010	3.7	1,239,644.6	22,494.7	-34,879.1	1,227,260.2	3.6	0.2	53.5	14.2
2011	2.5	1,300,624.1	18,020.7	-21,612.7	1,297,032.1	1.7	0.7	58.7	14.3
2012	1.6	1,335,488.3	12,441.5	-22,369.0	1,325,560.8	2.4	1.1	56.3	13.9
2013	1.4	1,364,781.8	1,793.9	1,165.6	1,367,741.5	1.9	-0.4	50.2	16.1

Burimi: INSTAT.
Publikimi 'Statistika fiskale Janar-Dhjetor 2013' tabelat:
Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (12 mujor në vite).
Shënime:
2) Përfaqëson kredinë për ekonominë.
3) Norma mesatare e ponderuar vjetore e depozitave dhe kredive të reja 12 mujore në lekë për sistemin bankar.
4) Të dhënat i referohen normës në fund të periudhës.
5) PBB 2012 Gjysëm-finale.
6) Ndryshimi i muajit dhjetor të vitit n me dhjetorin e vitit n-1.
7) Të dhënat sipas informacionit në faqen e internetit të INSTAT datë 08.01.2015: Temat/ Tregu i punës/ Anketa e Forcave të Punës/ Vjetore/ Shkalla e punësimit 2007-2013 (grupmosha 15-64 vjeç); Shkalla e papunësisë 2007-2013 (grupmosha 15-64 vjeç).

Source: INSTAT.
Publication 'Fiscal statistics January- December 2013'tables:
"Consolidated general budget (cumulative 12 months in years)". Footnote:
1) Deposits included in broad money.
2) Credit to economy.
3) The annual weighted average rate of the 12 months new deposits and loans in ALL for the banking system.
4) End of period data.
5) GDP 2012 Semi final.
6) Variation of December index of year n with December index of year n-1.
7) Data as of INSTAT web page tables, date 08.01.2015: Figures/ Figures by theme/ Labour market/ Labour Force Survey/ Yearly/ Employment rate 2007-2013 (age group 15-64 years): Unemployment rate 2007-2013 (age group 15-64 years)

3. BILANCI I PAGESAVE, REZERVA DHE KURSI I KËMBIMIT NË MILIONË EURO, PËRVEÇ RASTEVE KUR SHËNOHET NDRYSHE

BALANCE OF PAYMENTS, RESERVES AND EXCHANGE RATE 3. IN MILLIONS EUR, UNLESS OTHERWISE INDICATED

	Bilanci i llogarisë korrente/ Current account	Nga të cilat: Bilanci tregtar/ Of which:Trade balance (3+4)	Eksporti/ Export	Importi/ Import	Nga të cilat: Remitancat/ Of which: Remittances	Investimet direkte neto/ Direct investments, net	Rezervat valutore (stok)/ Reserves (stock)	Rezervat në muaj importe/ Reserves in months of import	Kursi i këmbimit/ Exchange rate	
									Mesatare e periudhës/ Period average	
									ALL / EUR	ALL / USD
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
2009	-1,329.8	-2,303.7	750.7	-3,054.4	781.3	688.7	1,646.2	4.2	132.1	95.0
2010	-1,018.6	-2,082.7	1,171.5	-3,254.2	689.8	788.5	1,904.8	4.8	137.8	103.9
2011	-1,225.2	-2,241.6	1,405.5	-3,647.1	664.5	608.9	1,912.5	4.4	140.3	100.9
2012	-978.0	-1,999.2	1,525.6	-3,524.8	675.3	647.9	1,972.5	4.7	139.0	108.2
2013	-1,035.1	-1,719.7	1,756.2	-3,475.9	543.8	923.2	2,015.3	4.7	140.3	105.7

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Source: Bank of Albania.

4. BILANCI FISKAL, STOKU I BORXHIT TË BRENDSHËM DHE BORXHI I JASHTËM NË MILIARDË LEKË

FISCAL BALANCE, DOMESTIC DEBT STOCK AND EXTERNAL DEBT 4. IN BILLIONS ALL

	Të ardhura/ Revenue	Nga të cilat: Të ardhura tatimore/ Of which: Tax revenue	Shpenzime/ Expenditure	Shpenzime kapitale/ Capital expenditure	Deficiti/ Deficit	Financim i brendshëm/ Domestic financing	Financim i huaj/ Foreign financing	Stoku i borxhit të qeverisë qendrore/ Central government debt stock	
								Stoku i borxhit të brendshëm/ Domestic debt stock	Stoku i borxhit të jashtëm / External debt stock
	1	2	3	4	5	6	7	8	9
2009	299.0	270.8	379.9	97.6	-80.9	70.7	10.2	415.0	267.5
2010	324.7	288.6	362.8	67.5	-38.0	27.8	10.2	407.4	308.0
2011	330.5	303.9	376.3	70.7	-45.8	26.1	19.8	438.6	333.9
2012	330.4	300.9	376.2	61.7	-45.9	26.5	19.4	470.4	357.6
2013	327.2	299.9	394.1	65.5	-66.9	56.1	10.8	520.8	363.9

Burimi: Ministria e Financave, sipas publikimeve "Statistikat fiskale, Janar-Nentor 2014" dhe Treguesit e Borxhit, TIII 2014".

Source: Ministry of Finance, according to "Fiscal Statistics, January-November 2014" and "Debt Indicators,Q III 2014" publications.

1. SEKTORI FINANCIAR
1-1 BILANCI SEKTORIAL I BANKËS SË SHQIPËRISË
NË MILIONË LEKË, FUND PERIUDHE

FINANCIAL SECTOR 1.
SECTORAL BALANCE SHEET OF BANK OF ALBANIA 1-1
IN MILLIONS ALL, END OF PERIOD

	Totali i mjeteve/ Total assets (2+3+4+5+8+12+13+14)	Ari monetar dhe mbajtjet e SDR*/ Monetary gold and SDR holdings*	Arka në valutë/ Foreign currency	Depozita/ Deposits	Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet / Securities other than shares (6+7)			Huatë/ Loans (9+10+11)				Derivatet financiare/ Financial derivatives	Llogari të arkëtueshme/ Receivable accounts	Mjete jofinanciare/ Nonfinancial assets
						Jorezidentë/ Nonresidents	Qeveria qendrore/ Central Government		Qeveria qendrore/ Central Government	Korporata të tjera depozituese/ Other depository corporations	Sektorë të tjerë rezidentë/ Other resident sectors			
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
2011/ 12	384,581.3	16,795.3	59.8	31,717.2	284,209.6	219,718.8	64,490.8	27,388.1	_	25,485.4	1,902.8	35.3	11,295.9	13,080.0
2012/ 12	394,833.6	17,703.3	67.5	30,517.5	294,007.2	229,313.1	64,694.1	23,706.8	_	21,800.2	1,906.5	14.2	14,129.2	14,688.0
2013/ 12	398,813.6	16,701.5	57.3	23,892.8	308,387.0	243,178.6	65,208.4	23,333.2	_	21,502.3	1,830.9	31.5	11,994.1	14,416.4
2014/ 06	404,209.0	25,512.7	29.5	19,125.4	303,019.1	239,209.0	63,810.1	26,346.7	_	24,561.9	1,784.8	25.6	15,272.4	14,877.6
07	415,090.0	22,509.9	28.2	19,072.9	305,679.8	242,041.1	63,638.7	34,710.2	_	32,935.2	1,775.0	19.8	18,148.2	14,921.0
08	437,065.3	18,855.6	29.1	33,646.0	318,922.6	255,037.4	63,885.3	31,730.8	_	29,962.4	1,768.4	13.6	18,951.5	14,916.2
09	442,504.6	19,010.2	25.8	36,446.1	319,486.4	255,537.4	63,949.0	33,922.5	_	32,161.6	1,760.9	21.7	18,621.4	14,970.5
10	440,134.4	18,693.2	22.4	36,355.7	315,009.3	251,083.4	63,925.9	36,790.4	_	35,038.2	1,752.3	27.4	18,279.4	14,956.6
11	439,228.5	18,925.6	22.2	35,367.5	314,464.4	250,527.1	63,937.4	36,755.0	_	35,010.4	1,744.6	19.0	18,561.4	15,113.4

	Detyrimet totale/ Total liabilities (2+3+4+10+14+15+16)	Paraja në qarkullim/ Currency in circulation	Depozita të përfshira në paranë e gjerë/ Deposits included in broad money	Depozita të papërfshira në paranë e gjerë/ Deposits excluded from broad money (5+6+7+8+9)						Huatë / Loans (11+12+13)				Llogari të pagueshme/ Other accounts payable	Alokimi i SDR/SDR allocation	Aksione dhe instrumente të tjerë të kapitalit/ Shares and other equity
					Jorezidentët/ Nonresidents	Qeveria qendrore/ Central Government	Korporata të tjera depozituese/ Other depository corporations	Korporata të tjera jofinanciare/ Other nonfinancial corporations	Sektorë të tjerë rezidentë/ Other resident sectors		Jorezidentët/ Nonresidents	Qeveria qendrore/ Central Government	Korporata të tjera depozituese/ Other depository corporations			
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16
2011 /12	384,581.3	202,906.6	102.8	108,016.5	8,318.7	10,465.6	88,570.2	20.5	641.5	4,852.0	4,852.0	_	_	1,064.3	7,647.1	59,992.0
2012 /12	394,833.6	200,898.7	187.3	120,691.0	10,042.9	12,887.1	97,054.7	37.2	669.2	3,870.7	3,870.7	_	_	1,680.5	7,557.9	59,947.5
2013 /12	398,813.6	207,792.7	249.7	132,764.9	9,706.5	22,239.2	100,031.3	62.5	725.4	2,919.3	2,919.3	_	_	1,828.3	7,287.5	45,971.3
2014 /06	404,209.0	207,779.3	137.1	137,796.8	12,974.5	23,346.0	100,485.4	71.5	919.4	2,569.3	2,569.3	_	_	655.5	7,372.9	47,898.1
07	415,090.0	211,218.9	2,210.5	143,197.7	16,649.5	22,114.2	102,895.0	74.4	1,464.6	2,461.7	2,461.7	_	_	1,135.6	7,394.7	47,470.9
08	437,065.3	215,549.8	66.2	160,586.3	16,605.6	46,356.2	96,220.9	75.5	1,328.1	2,327.1	2,327.1	_	_	1,238.2	7,464.1	49,833.6
09	442,504.6	215,653.5	96.6	162,763.8	16,595.7	50,209.3	94,507.8	78.8	1,372.3	2,296.0	2,296.0	_	_	621.4	7,661.8	53,411.4
10	440,134.4	213,788.4	679.9	163,702.1	16,573.4	49,671.3	96,284.4	78.7	1,094.4	2,266.6	2,266.6	_	_	611.6	7,619.8	51,466.0
11	439,228.5	216,961.2	117.9	157,915.2	16,578.6	37,477.0	102,849.6	80.9	929.1	2,276.5	2,276.5	_	_	835.0	7,639.1	53,483.6

Burimi: Banka e Shqipërisë

**Për periudhën dhjetor 2002-prill 2014 është bërë riklasifikimi i arit monetar nga zëri "Depozita" në zërin "Ari monetar dhe mbajtjet e SDR".*

Source: Bank of Albania.

**The data of December 2002-April 2014 reflect a reclassification of monetary gold from "Deposits " to " Monetary gold and SDR holdings".*

1-2 PARAQITJA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË
NË MILIONË LEKË, FUND PERIUDHE

MONETARY SURVEY OF BANK OF ALBANIA 1-2
IN MILLIONS ALL, END OF PERIOD

	Mjete valutore neto/ Net foreign assets (2-3)	Pretendime ndaj jorezidentëve/ Claims on nonresidents	Minus: Detyrime ndaj jorezidentëve/ Less: Liabilities to nonresidents	Mjetet e brendshme / Domestic assets (5+8+9+10+11+12)	Pretendime neto ndaj qeverisë qendrore/ Net claims on Central Government (6-7)	Pretendime ndaj qeverisë qëndrore/ Claims on Central Government	Minus: Detyrime ndaj qeverisë qendrore/ Less:Liabilities to Central Government	Pretendime ndaj korporatave të tjera depozituese/ Claims on other depository corporations	Pretendime ndaj korporatave të tjera financiare/ Claims on other financial corporations	Pretendime ndaj korporatave jofinanciare publike / Claims on public nonfinancial corporations	Pretendime ndaj korporatave të tjera jofinanciare/ Claims on other nonfinancial corporations	Pretendime ndaj sektorëve të tjerë rezidentë/ Claims on other resident sectors
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
2011 / 12	255,657.9	276,475.7	20,817.8	84,492.3	57,098.1	67,590.8	10,492.8	25,485.8	_	_	_	1,908.5
2012 / 12	266,540.0	288,142.1	21,602.1	78,858.1	55,145.6	68,057.8	12,912.2	21,800.8	_	_	_	1,911.7
